

Një javë pas përvjetorit të 149-të të Atë Gjergj Fishtës, "ExLibris" boton një shkrim ku përfshihen një pjesë shumë e vogël e artikujve që janë shkruar përgjatë viteve në shtypin e shkruar për të. Në këtë udhëtim kronologjik, vëmë re se si Padër Gjergji shihej nga sytë e njerëzve me peshë në kulturën shqiptare, duke u bazuar në çka u shkrua jo në ato revista apo gazeta ku intuira e çon këdo si "Hylli i Dritës" apo "Shëjzat", por në të tjera, më të vogla e me rreth më të vogël lexuesish si "Zani i Shna Ndout", "Tomorri i vogël" etj., shkrimet e të cilëve të befasojnë, ashtu sikurse befasohesh kur brenda një tempulli në dukje modest, gjen ndonjë kryevepër të rilindjes.

EPOKAT E ATË GJERGJ FISHTËS NË SHTYPIN E SHKRUAR

Shkrime për Fishtën nga Poradeci,
Stërmilli, Spasse, Repishti

Nga Andreas Dushi

(fq. 2)

KOLEGËT PËR DAN MUSLIUN

(fq. 16)

Para pak ditësh u nda prej jete Dan Musliu (31 maj 1954 - 22 tetor 2020), poeti dhe kritiku elitar i letrave shqipe. Ndarja prej jete e Danit la pikëllim të madh të natyrshëm te kolegët. Në këtë material përzgjedhëm vetëm disa prej shënimeve të tyre...

MITI I FEMRËS NË POEZINË E VISAR ZHITIT

Dr. Yzedin Hima

(fq. 8)

Në "Letërsinë e penguar", për shkak të rrethanave në të cilat kjo letërsi u nyjtua, figura e femrës është vërtetë një mit. Për shumë të burgosur femra ka qënë ylli polar që i udhëhoqi drejt lirisë përmes vuajtjeve mbinjerëzore të burgut.

NJË ROMAN I RI SA NJË VETËTIMË...

Stefan Çapaliku

(fq. 7)

Një vit mbas botimit të romanit "Extra time ose vehtja ime e dytë" po nga shtëpia botuese "Gjergj Fishta", Durim Taçi vjen me romanin tjetër të rëndësishëm "Një prani në ikje".

Mbi vëllimin e ri poetik të Rudolf Markut, "Rrathë të brendashkruar"

AGON ME REFLEKSET E SAMIZDATIT

nga Gëzim Basha

(fq. 10)



INFINITI I LEOPARDIT NË SHQIP

Yourgen Zmijanë

(fq. 6)

Me shumë gjasë poezia "L'infinito" e Giacomo Leopardit (1798-1837), duke tërhequr vëmendjen e përkthyesve shqiptarë në kohë të ndryshme, ka shënuar rekordin e gati një duzine variantesh në shqip.

GJASHTË VARIANTET E "INFINITI" TË LEOPARDIT

(fq. 9)

Në shqip: Ernest Koliqi • Andrea Varfi • Lazer Shantoja •
Nikollë Dakaj • Arshi Pipa • Aurel Plasari

Intervistë me kandidatin e përvitshëm
të Çmimit Nobel për Letërsi

NGÛGÏ WA THIONG'O: Jam një luftëtar i gjuhës

me Nanda Dyssou



(fq. 11)

BIBLIOTEKË

Aleksandër Bardhi

Kryq në zemrën e saj

(fq. 14)

Herman Hesse

Librat

(fq. 14)

Andrin Kabashi

Sadisti

(fq. 15)

ALEXANDER LARMAN

A është nepotizmi
artistik një e keqe
apo nevojë?

(fq. 18)

Një javë pas përvjetorit të 149-të të Atë Gjergj Fishtës, “ExLibris” boton një shkrim ku përfshihen një pjesë shumë e vogël e artikujve që janë shkruar përgjatë viteve në shtypin e shkruar për të. Në këtë udhëtim kronologjik, vëmë re se si Padër Gjergji shihej nga sytë e njerëzve me peshë në kulturën shqiptare, duke u bazuar në çka u shkrua jo në ato revista apo gazeta ku intuïta e çon këdo si “Hylli i Dritës” apo “Shëjzat”, por në të tjera, më të vogla e me rreth më të vogël lexuesish si “Zani i Shna Ndout”, “Tomorri i vogël” etj., shkrimet e të cilëve të befasojnë, ashtu sikurse befasohesh kur brenda një tempulli në dukje modest, gjen ndonjë kryevepër të rilindjes.

EPOKAT E ATË GJERGJ FISHTËS NË SHTYPIN E SHKRUAR

Shkrime për Fishtën nga Poradeci, Stërmilli, Spasse, Repishti

Nga Andreas Dushi

Sipas studimit bibliografik të Lili Sulës me titull “100 vjet shkrime për Fishtën” (*Skanderbeg books*, 2009) shohim se për Atë Fishtën shkruhet për herë të parë në vitin 1904 në rubrikën *Nel clero cattolico Albanese* të gazetës *La nazione albanese* ku në faqen 9 të numrit që mban datën 15 prill 1904, njoftohet se Padër Fishta është dërguar në Mal të Zi për të bindur P. Leonardo Goiano të kthehet përsëri në Shqipëri. Një vit më vonë, fillon të shkruhet për *Lahutën e Malciis*, bleu i parë i së cilës ishte botuar po atë vit. Pastaj, përgjatë viteve, sa më i njohur bëhej Fishta dhe vepra e tij letrare e studimore si dhe aktiviteti diplomatik e politik, aq më të shpeshtë ishin shkrimet për personalitetin e tij, duke hapur herë pas here edhe polemika apo duke krijuar debate.

Pjesa më e madhe e njerëzve të kulturës dhe të

letrave shkruajtën për të, në thuajse të gjithë periodikët dhe organet e shtypit që koha mundësonte. Në vijim, kemi përzgjedhur një pjesë të vogël, shkruar nga njerëz që me emrat e tyre krijuan një bazë të qëndrueshme mbi të cilën u ngrit letërsia shqiptare si Lasgush Poradeci, Haki Stërmilli apo Sterjo Spasse.

Por më përpara, po paraqesim pjesë nga dy poezi, *pengje nderimi* për Padër Gjergjin, botuar në numrin e posaçëm të “Zani i Shna Ndout” kushtuar atij me rastin e njëzet e pesë vjetorit të meshtarisë. E para është nga Atë Vinçens Prennushi dhe e dyta, nga Kristo Floqi.

Pëngu i nderimit – P. V. Prënnushi

T’falem, Atë Fishta: kandshem
Rrezet i reshi qilli
Mi ty, qi votra mkâme
Me msim qi nep Unjilli.
Me msim me vepra t’mara
Fjalët t’ua kjene fara
E nji uzdajës qi s’bjen.

Ty të lumtë! mahit e shekllit
Tu’i vû me kohë nën themer,
Me popull t’and ti deshte
Me kë në perherë nji zëmer:
Per popull ti qindrove,
Me popull veç jetove:
Shqypnija marë t’a rrfen.

Nën hije t’pagjët t’kuvëndit
Madhnove armët fatose;
Atdheu ty t’ndjeu, t’ndjeu bota,
E u bind. Ti vetë rropose
Pa shpatë idhujt e mndershëm,
E i dbove vëndit t’ndershem;
S’i lae kund me xânë vënd...

... Por s’hupin, jo, tokët t’ona:
Na i fali Perendija;
S’a tokë pa zot kjo e jona,
S’a tokë pa Zot Shqypnija.
Shqyptár, nuk ke pse tute;
Der sa nji jonë “Lahute”
T’kumojë, Shqypnija rrnon!



Kushtim mikut të dashtun e vjershtorit kombtar në zâ Atë Gjergj Fishtës - Kristo Floqi

... Mburret sot plaknesha Albiona,
Për byron e Milton Sakespearin
Mburren Teutonët per nji Goet’ e Schiller
Edhë Gallatët për Corneille e Racinin,
Për nji Cervantes Spanja Ibirike
E Poertogali me Camoens për Luisiadat,
Por se kujtonj nj’ashtu dhe Arbenia
Ka psë të mburret me ty, o At-Fishtë,
Qi me Lahutën e Malciis e aq të tjera
Vjersha lyrike e gjith farë zânit.
Atdheut nji shpirt të rii i fal’ e dritë.
Me lyrën e Xanonit e harpen e Naimit
Me të Kamardës luttën e lahutën t’ande
Kumoj dhe nj’hera Xana Arbnore,
-Qi sllig’e namun vllaget ja kish shterrë –
E deri lamsh i Dheut t’kthehet rrotull boshtit,
E të vettojnë hyllet nen të Qiellës kubë
Ka me gumxhitë e kjartë, madhshtore,
Mest shekujve, saa dit’ e Ruzullimit.



Dy janë shkrimet e njohura të Lasgush Poradecit për Padër Gjergjin: *Gjergj Fishta lirik, shkëmb i tokës dhe shkëmb i shpirtit shqiptar* dhe *At Gjergj Fishta vazhdimtar në mendimin e kombit*. Ngase shkrimi i pare është goxha i njohur, në vijim mund të lexoni shkrimin e tij të dytë, botuar në *Tomori i Vogël*, janar 1943.

Nga Lasgush Poradeci

Fryma, Parim i perëndishmë që përpara herës, Mendim krijonjës dhe përmbajtës i bërë fjalë për të urdhëruar të-vetat, qëndronj, si në fillim të qënies, mi faqen e valëve në fillim të Ringjalljes shqiptare. Ky ish Mendimi Kombëtar, Fryma, përmbushëse e destinit të një Kombi. Ishte Shpirti i përmbajtjes që u bë Fjalë dhe njeri për t’u lajmëruar. Me këtë Frymë në gojë, Parim jetëdhënës, u dërguan Dërgimtarët shqiptarë në botën shqiptare, lajmëtarët e Mendimit të Kombit.

Ç’ ishte ky Mendim – Frymë, Fjalë, Parim drite i pavdekur? Ish Mendimi i vetëdijes. Fjala e jetës shqiptare. Ajo ndrit errësirën dhe hap të fshehtën e



punrave. Gjen dhe shpall të Vërtetën. Bisedon, për të njohur të Vërtetën shqiptare, edhe Zotin vetë, të Cilin e parashton kombëtarisht mi tryezë. Dhe gjen pra kësioj prej ndarjes dhe përçarjes së vjetëruar, bashkimin kombëtar më fenë dhe më Zotin.

Ky ish mendimi i bërë Fjalë në gjuhën e Dërgimtarëve të Kombit, të atyre që parapërgatitnë Rilindjen, të atyre që e ndërtuan, dhe të atyre që e vazhduan me Frymën e parë, e cila do të mbetet, siç është, e përgjithnjëshme. Me këtë mendim në zemër e në gojë u vërsulë drejt qiellit të Kombit, si parathënës të perëndishmë, Naum Veqilharxhi në Rumani, Efthim Mitkua në Egjipt, Anastas Kullurioti në Greqi, Hallaramb Koçi në Rusi, me gjithë vargun e bashkëvalletarëve brenda dhe jashtë Atdheut. Me këtë Mendim, Mendim të Kombit në zemër e në gojë, muar hov Dërgimtarët e Frashërit, në ballë Naim Frashëri, Pashko Vasë Pasha Shkodrani, Mihail Gramenua, ndërtimtarë të Rilindjes. Me këtë Mendim vetëshugurohet At Gjergj Fishta vazhdonjës në udhën e Dërgimtarisë shqiptare.

Vjershëtori Naim Frashëri, një bektashi shqiptar, puth Krishtin në emër të Kombit dhe dyke e adhuroar, lajmëron përmbledhjen e madhe të Shqiptarëve në Fenë e përbashkët të atdhedashurisë. Fjala e tij është Frymë, Parimi, Shpirti i përjetshëm i Dërgimtares shqiptare:

*Djalëth, njeriu i Perëndisë,
Zot, ti ke vuar.
Dhe dashurinë e bëra besë,
Të qofsha falë!*

Diplomati Pashko Vasa, një katolik shqiptar, sodet vetëveten për të gjetur Mendimin e Kombit, dhe dyke e gjetur lajmëron gas të rëndë, në atë Vajën e tij që është vërtet Himni i math shpëtimtar, marshi bashkonjës i fateve shqiptare në Mendimin e Kombit, në Fenë e përbashkët të Shqiptarisë:

*Çohni, Shqiptarë, prej gjumit çohni,
Të gjith si vllazën në një bes' shtërngohni
Edhe mos shikoni kisha e xhamija,
Se feja e Shqiptarit asht Shqiptarnija.*

Kryengritësi Mihal Grameno, një orthodhoks shqiptar, këndon vjershëtorët dhe dëgjon veteranët, mëson Mendimin e Kombit dhe shpall Shpirtin, Vëllazëri e pandarë, Fe kombëtare:

*Njëri në kisha, tjetri në xhamija,
Jemi vëllezër, s'na ndajnë dot.*

Edhe prifti Gjergj Fishta, Vazhdimtar në udhën e Kombit, Frymëtar i Fjalës, solli Dhuratën e vet në Adhurimtoresh e Atdheut – Shpirt, Mendim i Parathënësve të Shqipes. Ay e solli me gjithë vargun e shprehjeve bashkimtare dhe vëllazërmitare fetare të falura në gojë të polemës shqiptar dhe të krerëve shqiptarë dhe të udhëheqësve shqiptarë, të cilët *lidhin besë e fe shqiptare* ndaj Rezikut – Mendim i kombit, Parim atdhedashurije. Më shumë, sepse dyke bërë dorëzim pavdekësisë, ay i-a pruri dhuratën *Lahutës* së tij me kombëtarësimin e fatosit shkodran Oso Kuka, të Ali Pashë Gusinjes dhe të *Hajrijes* në pavetëdi, të ridhënë Atdheut përngahera nga humbja e mosqënies. Veprimi krijimtar i Gjergj Fishtës, i këtij krijimi kombëtar të vetëdijshëm prej kombësisë shqiptare së pavetëdijëshme, është ay i endjes, së pari, nëpër Purgatorin e vetëvetes spastronjës, ay i faljes në Adhurimtoresh e Mendimit të Kombit. Si një kushtimtar i vyer për punën e kushtimit të tij, m'a pat bërë Fishta, vetë ay me gazin e fjalës së vet, këtë Apokalipsë të madhe shqiptare. Vajta t'a shoh rishtas më 1937, në Shkodër në Kuvend. S'e gjeta... Ardhi më mori... Folmë mi mjeshtëri të vjershës në atë tryezë përallore. Në libërën t'ime të falur, i kisha shkruar pjesën e njëqindtë nga ç'desha:

*Njeriut të Zotit meditans dhe militans,
Burrit shqiptar përfaqësonjës,
Më të madhit epik të shekullit.*

Si shpërblim fisnikërije për këtë të vërtetë, Fishta më përkëdheli – toskërisht: “Lasgush, unë mirë të lexoj, mirë kuptoj. Ajo mënyrë e brëndshme është mundim,



(poshtë) Atë Gjergj Fishta, Asdreni (lart) Lasgush Poradeci, Ernest Koliqi.

vojttje. Edhe unë do të mundja të shkruaj ashtu, veçse druhem...”. “Pater, shkruaj pasi e kam mundur dhëmbjen dhe vojttjen, pasi jam pastruar – në kujtim...” Atëherë, Fishta pohoj dyke u zbuluar: “Vërtet, kam bërë unë kështu me Oson, Alinë, Hajrijen...”

M'a shpjegoj pastaj i çelur në zemër atë vepërim kureshtjeje të fshehtësirave të punëtorisë vjershëtoresh, që është fshehtësija e forcës dhe e fuqisë së racës shqiptare, atavizma dhe dinamizma e gjakut shqiptar, Frymë, Parim, Fjalë e përjetshme e Mendimit të Kombit.

Një prift tjetër, Fan Noli, Dërgimtar shpirt Dërgimtari i Shqipes, bëri më vonë prej këtij Mendimi të Kombit Mendimin e Flamurit të therrorisë dhe të Bashkimit të shentë kombëtar:

*Flamur! që linde Shen Kostandinë!
Bashkon Islaminë me Krishtërimnë!
Flamur: altar për therrori!*



Po aty, në atë numër të posaçëm për Fishtën, gjendet edhe shënimi i shkurtër i Haki Stërmillit:

Deri n'agimin e lumtun të lëvizjes s'onë kombëtare që nisi me Ligjën e Prizrendit, mund të thuhet sa të pakë qenë poetët që kënduen e vajtuen për këtë popull të strukun në këtë kand të siudhesës Ballkanike. Poetët

popullorë, si e dijmë të gjithë, nuk qenë në gjëndje e nat nivel kulturuer që të mund të shpreheshin në mënyrë të shkëlqyeshme për me ngacmue ndërgjegjen e këtij Kombi të fliuem gjatë shekujve për lirin e adhurueme. Vetëm mbas Lidhjes së Prizrendit, Shqipnia pat fatbardhësin me e ndigjue zanin e ambël të poetit të vërtetë që kumboj ndër vargje të harmonishme për lirin e shtrenjtë. Dy yj u dukën atëherë, me të tanë shkëlqimin e vet, në Qiellin e kaltërt t'Atdheut të Kastriotëve të squlloun mija herë me gjak martyrësh e herojsh. At Gjergj Fishta në Veri dhe Naim Frashëri në Jugë.

Prodhimi poetik i këtyne dy viganëve të letërsisë s'onë, e zgjoi, e mëkoi dhe e flakëroi ndërgjegjen kombëtare të popullit, i cili me të tanë hovin burruer që e shquen dhe me të gjitha forcat e shpirtit që e pasunojnë, u hudh në luftën e shenjtë për rifitim e liris së humbun qysh nga perëndimi i epokës së lavdishme Skenderjane.

At Gjergj Fishta, me zotësin e vet të pashoqe, dijt me e argëtue shpirtin e gandum të Kombit dhe me e përtëri me forca të pashterruna bese e burrniye, pajë e trashëgueme prej stërgjyshavet t'onë krenarë. Lahuta e Malësis, Mrizi i Zanave dhe Anzat e Parnasit përbajnë tre diamantët e shkëlqyeshëm në kunorën e lavdis së tij të përjetshme dhe e ngjisin në kikël të poezis shqiptare. Ai luejti, me anë të veprave të veta poetike, një rol kryesuer e të shënuem në përgatitjen e Kombit për ngadhnimin e 1912-ës.

Zbrazësia që la At Gjergji, tue u largue nga mezi i jonë për në jetën e amshueme, urojmë të mbushet sa

më parë e të zavendësohet prej ndonji të riu që t'i napi fund mâ vajit dhe t'i këndojë liris, bukuris e virtytit të racës s'onë të pandragun kurrë.

Tue e përkujtue humbjen e këtij poeti të madh që polli nana Shqiptare, përulemi përvujtnisht para shpirtit të tij dhe lusim t'a lusë Hyun për Kombin e Atdheun t'onë që ai aq fort vajtoi e këndoi.



Ndërkohë, pak pas vdekjes së autorit, *Shkolla Shqiptare* e hap një numër të hartuar posaçërisht për këtë rast me një shkrim të Sterjo Spasses me titull “Me lyrën e me veprën e A. Gj. Fishtës”:

... Dikur Naim Frashëri me lyrën e vet këndoi zulmën e Skënderbeut, atë zulmë që duhej të përtrihej në rembat e të gjithëvet për t'u-ringjallur kombi i ri. Bota gëzohej për famën e dikurëshme të shqiptarvet, mirpo nata të soçmit nuk gjente asnjë dell Kastrioti. Thua se raca e jonë kishte mbaruar që përpara pesë shekujvet! Por ky mohim ishte padrejtësia më e madhe që i bëhej racës s'onë. E klithmën e fortë t'ankimit e të dëshpërimit, klithmën alarmonjëse për armiq të e për atdhemohonjësit e nxorri A. Gjergj Fishta:

*Por po kisht' besa, Shqyptarë,
Kisht, Shqyptar' zemër bujarë...
Burra t'urt', trima luftarë,
Qi s'po u tutshin kta me dekë
M'erz a m'tok' me pas' me i prekë.*

Klithma e Fishtës ishte klithma e Kombit vetë! E Poeti i Math kapi Lahutën e malësisë edhe nëpër telat e saja të ngrehura me dorë mjeshtri të përsosur na zbulon *shpirtin e vërtetë kombëtar*. Me zërin e fortë të një ngadhënjonjësi Ay na tregoi nëpërmes të vargjevet të Tij të panumërta se Shqipëria e vërtetë, Shqipëria e kreshnikëvet e të shqiponjavet, Shqipëria kult i bujarisë, i trimërisë, i nderit edhe i besës gjindet e gjindet atje tej ndër *malësitë t'ona!* Andej, po, në fellësisirat e malevet, nëpër shkrepat maja – maja, nëpër gërxhet shumëformëshe, nënë hijësisirat e dendura të pyjevet, mbi gjelbërimet e lëndinavet, gjatë shushurimës së projevete edhe nënë ledhatimet e këngës së bilbilavet shekuj me radhë *ishte strukur origjina e vërtetë e racës s'onë*. Fryjtën murrulanët e rrobërisë me shekuj, armiku shkeli e çnderoi, dogji e poqi me qindra vjete mbi kurrizin e Shqipërisë, por andej ku shtrihej kufija e malësivete as *gëk* nuk bëri dot. Atje në vetmin e përhershme, larg botës që sillej e përsillej nga frynte era, mendja e pastër shqiptare punonte me thjeshtësinë e saj, lyra ruhej e gjallë si kurdoherë edhe nëpër buzët e virgjëra të vashës malësore e nëpër zemrën trime të djemvet të papërkulur kurrë, Muza Shqiptare qendiste gjatë kohëvet trimërinë, bujarinë, besën, nderin, zakonet e vallet shqiptare. Këto të qendisura Muza ia dorëzoi *A. Gjergj Fishtës* e Ky me këto thurri epopenë më madhështore “*Lahutën e Malcís*”. Kjo Lahutë çfaq ndiesitë më të thella edhe karakteristikat më të kristalizuara, që i ka ruajtur raca shqiptare përmes shekujvet plot shtrëngata. Dhe ç'mrekulli e gjallë: Vargu kumbonjë e nxjerr malësinë me tërë thjeshtësinë e origjinalitetin e ‘saj: Ja mikpritjet tradisjonale, ja nderi, ja burrërija, ja besa tek burrojnë nga çdo veprim i thjeshtë i malësorit aty nëpër majat e thepisura e ndërmjet kopevet të bagëtivet. Përmes kësaj jete të thjeshtë flakërojnë heronjtë si *Marash Uci* – tipi më i përsosur i urtësisë e i bujarisë shqiptare – *Oso Kuka*, - simboli i trimërisë – e radhazi ngjallen gjithë kreshnikët e tjerë, që s'dijnë të tronditen as të zbrapsen përpara rrezikut për hir të lirisë kombëtare, të besës e të nderit! Ndërmjet këtyre episodevet ndërlikohen Zanat, Orët, Shtojzovallet e bestytnit e ndryshme. Vargu i math i protagonistëvet të kësaj lahute mendojnë, ndjejnë e veprojnë shqiptarisht; nga goja e çdo Marashi e Osoje del ajo fjalë burri, që ka simbolizuar krenarin t'onë kombëtare përmes shekujvet.


Jehona e botës malësore së pari ndihet lehtë dhe e harmonishme, hë – hë pastaj e rëndë dhe tingëllonjëse edhe së mbrendëshmi, kur fillojnë të veprojnë viganët e racës, jehona del e rrufeshme përmes barutit, martinavet e gjakut! Vargu vetë të trondit, fjala sakaqë të huton edhe veprimi i tërë episodeve të jep shpirt, të ngjall, të thëthit: vehten e ndjen kreshnik edhe

fillon vet-vetiu të heqish vallen e viganëvet bashkë me protagonistët. E ja: Lahuta fluturon nga goja e nga dora e Poetit me krahë shqiponje mal më mal, bjeshkë më bjeshkë, pyll më pyll e zemër më zemër.

... Zemra e *Fishtës* është një vullkan, që ndjen e që vuan: nga kjo zemër vullkanike derdhen si lava lyrikat e odet e Tij të pavdekura. “*Mrizi i Zanavet*” të poetit është kulti nga flakërojnë ndijesit me të thella atdhedashurije, hymnet më të përsosura për Shqipërinë, rruferat më të tmerrshme për armikun edhe përmbi këta ngre krye pasuri, bukurija e harmonija më e përsosur e gjuhës shqipe...

... Gjuha në çdo varg pasqyron thesarin e saj më të math, stili kudo merr rrjedhshmëninë e dliresinë më të plotë, forma poetike kudo bëhet më e harmonishme edhe dufi i zemrës në çdo fjalë çfaqet më i fortë: Lyrikat e Odet rrëmbehen e bëhen prona e të gjithë shqiptarvet.

... Jeta e tërë e *A. Gjergj Fishtës* është symbol i genisë së racës s'onë: me veprat e veta heroike, satirat dramatike Poeti hymnizon kreshnikët, ndezi zëmrat e shqiptarvet për ideale të lartëra, drodhi e përdrodhi si rymë ilektrike lithargjinë e ndjenjës kombëtare, pasuroi e harmonizoi sa s'ka më bukur gjuhën, i dha shkas edhe nxiti me furri të jashtëzakonshme përparimin e shkollës shqiptare, këndoi e lavduroi urtësinë edhe drejtësinë nëpër rrugën e Zotit edhe përmbi të gjitha ringjalli trimërinë, bujarinë, nderin edhe besën t'onë tradisjonale.



Sikurse dihet, ardhja e komunizmit solli ndalimin e veprës së Fishtës. Për të fundit herë, nën regjinë e Zef Zorbës u vendos në skenë një tragjedi e tija, *Juda Makabe*, me rastin e pavarësisë, 28 nëntor 1945. Shfaqja u dha tri herë, e mandej u ndërpre me urdhër direkt nga Mehmet Shehu. Gjatë kësaj kohe, në shtypin e shkruar shqiptar, ka një heshtje thuajse totale për të, përveç rasteve kur përmendet duke u parë si *reaksionar* apo *shkrimtar i dobët* nga figura të njohura të letrave, por edhe politike, deri edhe vetë diktatori Enver Hoxha.

Në *Konferencën III të Lidhjes së Shkrimtarëve* (9 – 12 tetor 1949), Sejfulla Malëshova del në mbrotje të tij, duke thënë mes të tjerash, “*Faik Konica, Fan Noli dhe Fishta janë figurat më të mëdha të Shqipërisë në*

fushën e kulturës”. Ai ishte kundër ndarjes që bëhej mes Mjedës dhe Fishtës nga pushteti. Si përgjigje, ndër të tjera, Shefqet Musaraj i kthen “*Krerët reaksjonarë të klerit katolik (ne e dimë se ç'krerë aprovonte Vatikani për të udhëhequr klerin katolik në Shqipëri) nuk e mirrin ashtu kot nëpër këmbë Mjedën, po për arësytën e vetme se nuk gjenin tek ai shërbëtorin besnik që u duhej siç e gjetën te Fishta*”. Në vitet e mëvonshme, janë studiues të tillë si Virion Koka, Rakip Beqaj etj., të cilët në librat e përgatitur si dëshmi e “veprimtarisë antikombëtare të klerit katolik” përfshijnë rolin e Fishtës të parë në këtë drejtim.

Pak para konferencës së lartpërmendur, Enver Hoxha, sikurse shkruan në vëllimin IX të veprës së tij, në diskutimin e mbajtur në mbledhjen e Byrosë Politike më 7 qershor 1949, mes të tjerash ka thënë “*Por sipas pikëpamjes sime, Fishta me satirat e tija nuk pin ujë përpara ‘Epopesë së Ballit Kombëtar’ të Shefqet Musarajt. Veprat e shokëve tanë që shkruajnë për luftën, për jetën dhe punën e popullit qëndrojnë më lart, janë me një përmbajtje më të shëndoshë*”.

Ama kjo rrymë ekzistonte në Shqipëri, por jo mes shqiptarëve! Të gjithë organet e shtypit jashtë atdheut bënë një punë të madhe në ruajtjen, promovimin dhe studimin e pasurisë së jashtëzakonshme letrare që la Padër Fishta. Mes tyre, punën më të çmuar e bëri “Shëjzat” në Romë ku u botuan me dhjetra artikuj për të nga Ernest Koliqi, Martin Camaj, Karl Gurakuqi, Daniel Gjeçaj, Giuseppe Schiró, Maximilian Lambertz etj.. Por edhe të përkohshmet shqiptare në Amerikë dhanë kontribut në këtë aspekt. Mes tyre përmenden *Shqiptari i lirë*, botuar në New York apo *Dielli*, botuar në Boston.

Krist Maloki, në një shkrim të botuar në këtë gazetë më datë 21 dhjetor 1960, mes të tjerash shkruan:

Sa për Gjergj Fishten emigrata shqiptare nuk ka ba shumë... Jan shkruar, po, aty e këtu do artikuj me pak e aspak substancë, ma teper sa per sy e faqe, si asht zakoni nder ne nder disa raste që nuk mund të perkalohen...

Gjithsesi, kjo nuk e hedh poshtë punën e periodikëve të lartpërmendur, përkundrazi: sikur e nxit të bëjë më shumë në këtë aspekt.

Në dy numra rresht të vitit 1966, përkatësisht nr. 47 dhe nr. 48 të “Dielli” është Sami Repishti ai që shkruan për Atë Fishtën. Fillimisht i bën një jetëshkrim të shkurtër duke përkujtuar 25 vjetorin e vdekjes së tij:

... At Gjergj Fishta lindi në katundin Fishtë të Shkodrës më 23 tetor 1871. Mësimet e para i mori në seminarin katolik të Troshanit... I frymëzue nga ndjenja fisnike dhe dashunia për këtë turmë të vorfënisht dhe të paditunish, entuziast për visaret e zbulueme në treva të harrueme, Fishta i u vu punës me shkruar, me folë, me tregue. Tribuna e tij e parë qe ALBANIA e Faik Konitzës në Bruxelles... Në 1908 Fishta qe nder kontribuesit ma të çquem, në punen e Kongresit të Manastirit. Pikërisht në këto vite vendimtare për fatin e Shqipnisë, Fishta filloi perpunimin e kangëve të para të LAHUTES, një thirrje madhështore ndjesive atdhetare për shembulltyrën në fëtyrat heroike të Oso Kukës, Marash Ucit, Abdyl Frashërit, Ali Pashë Gucisë etj..

Pastaj tregon aktivitetin e tij letrar e politik duke u ndalur në fillimin e botimit të “Hylli i Dritës” si dhe vitbotimet e veprave të tij. E mbyll me mënyrën se si po trajtohej ai në Shqipërinë e kohës.

Mbas ardhjes në fuqi të komunizmit, emni dhe veprat e At Gjergj Fishtës u perbuzën dhe u eliminuen. Fishta u quejt reaksjonar, dekadent dhe sherbëtuer i klasës feodalo – bajraktare. Leximi i veprave të tij u konsiderue një krim kundër Shtetit. Sulmi kundër Poetit Kombëtar ishte veçanërisht i fortë gjatë perjudhës së kontrollit jugosllav në Shqipni (1944 – 48).

Sot njizet – e – pesë vjetë mbas vdekjes së tij, At Gjergj Fishta mbetet një figurë kombëtare e dashtun nga të gjithë shqiptarët, dhe i çmuem nga rrethet letrare të vendit t'onë dhe botës së jashtëme. Shterpësija e prodhimit letrar, nen rregjimin komunist, ka revelue, edhe ma shumë se perpara, vlerat e mëdha të poetit, shkrimtarit, atdhetarit At Gjergj Fishta. Me gjithse ende i fyemë e i përbuzun nga rregjimi komunist, Frati i pervuejtë Françeskan vazhdon të jetë persri burim frymzimi dhe gurrë ushqyese për breznitë e sotëshme



ashtu siç qe dje, ashtu siç do të jetë edhe nesër.

Sepse emni i At Gjergj Fishtës, i përket atyne, që nuk vdesin, kur trupi rrëzohet.

New York 30 Dhetuer 1965
SAMI REPISHTI

Po në atë faqe të po asaj gazete është një rubrikë tjetër e quajtur **“Të njofim At Gjergj Fishtën”** ku shkruhen vlerësime të ndryshme për të.

At Gjergj Fishta:
“... asht Orfeu i Shqipnisë.”
La Revue de deux Mondes

“... asht ma i miri shkrimtar i Ballkanit”
La Giovine Europa, 1919

“... asht Rabintranath Tagore”
Dr. Erwin Tranik

“... asht Apostulli i Atdheut të vet.”
Antonio Baldacci

“... asht prodhimi i gjenisë së fisit Shqiptar.”
Dr. R. Petrotta

“... asht i ngjashëm me GOETHE dhe SCHILLER”
Dr. Karl Steinmetz

“... asht fat i jashtë-zakonshëm i Shqipnisë.”
Dr. Max Lambertz

“... asht nder e lumni e Urdhnit Françeskan.”
Papa Pius XII

“... Poeti i madh i popullit të lavdishëm Shqiptar.”
Gabriele d'Annunzio

“... ‘Lahuta e Malcisë’ krahasohet me ma të naltat vepra poetike të popujve tjerë.”
M. A. F. von Godin

Një javë më vonë, është po Repishti ai që boton kujtimet e tija nën titullin “Kujtimet e një nxanësi kur vdiq Pater Gjergji”:

Ka vdeke Pater Gjergji! (Kujtime të një nxanësi)

Njizet e pesë vjetë ma parë në një mbramje Dhëtori, vdiq në Kuvendin Françeskan të Shkodrës, At Gjergj Fishta, poeti i epikës madhështore – dhe frymëzuese – të popullit t’onë, liriku i çqmuem, dramatiku i fuqishëm, dhe padyshim autori i satirës ma të përsosun të letërsisë shqipe.

At Gjergj Fishta, frati i kushtuem mësimet dhe shembullit të Shen Françeskut, zëmra e dhanun pa kushte dashnisë për Shqipni, mendja që synoi pashim zgjimin dhe ngritjen e ndergjegjes kombëtare shqiptare, vdiq në një kohë ndoshta, kur ma shumë se kurrë, zjarri i fjalës dhe forca e pendës së tij i duhej një

sinë që e njihte dhe e çmonte shumë të ndjerin At jo vetëm si një fetar të shquar dhe apostull të Krishtit, por edhe sidomos si patriot të nxehtë e si poet të math që ka lartësuar në veprat e tija të pavdekëshme vetijat luftarake të Kombit shqiptar.

Me të marrë lajmin e hidhur të vdekjes së të ndjerit Akademik t’Italisë dhe poetit kombëtar, një shumicë qytetarësh filloi të vejë në Kuvendin e Etënve Françes-

kanë për t’i parashtruar trepit të të ndjerit nderimin u fundit. Shquanin autoritetet dhe parijs e Vendit, të cilët i bënë ngushëllimet e rastit Atit Provincial t’Etënve Françeskanë.

Qeverija vendosi që varrimi i të ndjerit të bëhet me shpenzimet e Shtetit.

Në mbrëmje arrijti në Shkodër Ministri i Punëve të Mbrendëshme Shkëlqesa Maliq Bushati.

Njoftimi për vdekjen e Fishtës në shtypin e shkruar

populli të mashtroem me një atdhe të robnuem.

Ishe student i klasëve t’ulëta të Liceut natë kohë, të shkollës që ma vonë u quejt Lyceu At Gjergj Fishta, në shej nderimi për shkrimtarin e rrallë. Që në mëngjez lajmi u hap menjherë. Në klasët gjysëm – të – ngrohta të ndertesës shkollore, efekti i vdekjes së Fishtës kishte prekë të gjithë ne, ashtu siç ngjet me një ngjarje që kalon kufijt e zakonëshme të jetës së perditëshme.

Ka vdekë Pater Gjergji! Ndoshta kjo asht forma ma familjare që në Shkoder e kishim zakon me thanë kur shqiptojshim emnin e Poetit. Ndoshta edhe vetë ky familjaritet i ndiemë e i pergjithshëm tregon ma shumë se çdo shprehje tjetër sa afër nesh jetonte Fishta, sa ngushtë me mendimin t’onë, dëshirat e shpresat t’ona, jetonte Poeti që perjetësoi epopenë vigane të një populli që nuk desht të jetonte i skllavnuem.

E kam pa Fishtën për të paren herë në vjetin 1937, kur një qytet i tanë, Shkodra, përcolli në një banesë mortore të re, trupin, pa skelet i këputun, të Hasan Riza Pashës. Në një pod të ngritun me nxitin pikërisht mbi trollin ku kishte ra gjaku i të vramit me tradhëti, folësit hypen e zdrypen pa mujetë me shkëputë turmen nga pesha, që ceremonija e permortëshme kishte randue mbi to. U desht Fishta at-herë, me thanë fjalën e vet. Aty kam pa fëtyrat, me mija, drejtue nga Ai që i terhiqëte, pa muejtë me u shkëputë, sikur fjalët e shqiptueme nga Fishta permabanin një mbështetësi të paditun. Asnji herë ma vonë gjatë jetës s’ime, figura kryesore e qendresës së Shkodrës, nuk masht paraqitë ma e qartë.

Radhen tjetër kur e pashë, Fishta ndehej, palëvizje e pa-za, ndëhej pa shpirtë mbi podin mortuer të vendosun në mesin e Kishës Françeskane, banesa e tij për shumë vjetë të gjata, banesa që tri ditë ma vonë i ofroi një vend të qetë për pushimin e perjetëshem.

Të rreshtuem dy nga dy parakalonte turma në heshtje dhe respekt të thellë. Silleshim rrotull arkës mortore, në një procesjon dhimbje dhe nderimi. Mbështjellë në zhgunin e murrme në të kuq, me të bardhin litar ngjeshun që tre premtime të bame të kumit të kujton, fëtyren bardhë si bora, duert bashkue në një kryq druni të zi, Fishta që për ne xanësit zente një vend n’Olimp me të pa-vdekshmit, nuk mund t’ishite ajo kufomë që nuk flet, që nuk punon. Cila ishte ndjesija që na mbushte zemrat t’ona rinore nato ditë, nuk mund t’a tham me siguri. Ishte diçka si një perziemje e habitjes që shkakton pamjen e kufomës palëvizje me dyshimin e një të riut: a vdesin njerzit e mëdhaj? Ata që na frymëzojnë, na japin jetë, na ushqejnë me mendime, na ngjallin ndjesitë fisnike, na nxisin për veprim, na bajnë me një fjalë me qenë diçka ma shumë se një frymuer që lëvizë pa synim, një qenje me ide e vullndet, ata pa dyshim e vejnë vehten e tyne në një pedestal ma të naltë, ma të plotë, ma të sigurtë, një pod që për ne njerzit e thjeshtë paraqitet si stoli i pamërrijtëshem: një seli që i takon të pavdekëshemve.

Por Fishta kishte vdekë! Dy ditë ma vonë një qytet mbar e percolli, veshun në zi, njeriun që ma shumë

se asnji tjetër ndoshta – në mes t’atyne që jetojshin – kishte unjisue emnin e vet me kryenaltësinë e një turme që kurr nuk deshti të njohë peruljen

SAMI REPISHTI
New York 30 Dhetuer 1965

Pas viteve ’90, me fillimin e tranzicionit, vërehet një qasje krejt ndryshe në raport me Atë Fishtën. Fillimisht në revistën *Jeta e re* në Kosovë, Anton Berisha flet për dramatikën e tij e më pas, edhe Martin Camaj i cili boton një shkrim rreth shndërrimeve e përpunimit të thënieve popullore në Lahutën e Malcis me rastin e 50 vjetorit të vdekjes së poetit. Po atë vit, në gazetën *Drita* të Tiranës, Skënder Buçpapaj boton shkrimin *Njëri ndër sovranët e letrave tona*.

Nga ’91 e në vijim, shkrimet për të do të ishin të pafundme, në të dy anët e kufirit që ndan shqipfolësit. Stefan Çapaliku, Aurel Plasari, Tonin Çobani, Rudolf Marku, Atë Zef Pllumi, Atë Konrad Gjollaj e sa e sa të tjerë, do të shkruanin për Fishtën aq shumë, me synim rivendosjen e tij në pedestalin ku i takon si dhe për të krijuar një kontekst studimor në të cilin mund të rimerrej për lexim dhe shqyrtim vepra e tij letrare.

Sot, Padër Gjergj Fishta, studiohet gjerësisht, nga klasat më të hershme të arsimit të detyruar, deri në disiplinat ku përfshihet epoka e krijimtarisë së tij në profilet letrare të studimeve universitare. Ka një numër të madh doktoraturash të mbrojtura rreth temave që lidhen me letërsinë e tij si dhe artikuj të shumtë në të përkohshmet (duhet thënë, të pakëta!) që merren me studime letrare. Sepse tani është e qartë për këdo që letërsinë e ka seriozisht: Pa Padër Gjergjin, letërsia shqipe është e mangët. Këtë përfundim nuk e nxjerr unë, e kanë thënë me dhjetra të tjerë para meje, edhe kur merreshin në pyetje nga hetuesia gjatë gjyqeve komuniste.

Sheshe, bulevarde, biblioteka, shkolla e të tjerë institucione kulturore, duke mbajtur emrin e tij nuk nderojnë atë, por vetveten sepse e krijojnë identitetin e tyre të mbështetur mbi parvazin e dritares pas së cilës shfaqet botëkuptimi i Fishtës. Tanimë, pas një tjetër parvazi, nën *hajat t’Parrizit* sikurse titullohet një poezi e tij, vetë Padër Gjergji sheh me buzëqeshje e dhimbje se pickimet e *anzave të Parnasit* nuk po pickojnë më njeri, pasi modeli i shoqërisë shqiptare, më shumë se kurrë i ngjan kujtdo personazhi të *Gomari* i *Babatasit*, përveçse vetë *Babatasit*!

P.S: Shkrimet janë marrë nga periodikët “Tomorri i vogël”, “Zani i Shna Ndout”, “Shkolla Shqiptare”, dhe “Dielli”. Punimi bibliografik i prof. as. dr. Lili Sulës “100 vjet shkrime për Fishtën” ishte një

Sempre caro mi fu quest'ermo colle,
 E questa siepe, che da tanta parte
 De l'ultimo orizzonte il guardo esclude.
 Ma sedendo e mirando, interminato
 spacio di là da quella, e sovrumani
 silenzi, e profondissima quiete
 Io nel pensier mi fingo, ove per poco
 Il cor non si spaura.. E come il vento
 Odo stormir tra queste piante, io quello
 Infinito silenzio a questa voce
 Vo comparando: e mi sovvien l'eterno,
 E la morte stagioni, e la presente
 E viva, e il suon di lei. Così tra questa
~~Infinita~~ ^{Immensità} s'annega il pensier mio:
 E il naufragar m'è dolce in questo mare.

INFINITI I LEOPARDIT NË SHQIP

Yourgen Zmijanë

Me shumë gjasë poezia “L'infinito” e Giacomo Leopardit (1798-1837), duke tërhequr vëmendjen e përkthyesve shqiptarë në kohë të ndryshme, ka shënuar rekordin e gati një duzine variantesh në shqip. Teknika klasike me të cilën janë modeluar vargjet e saj është vetëm njëra anë e medaljes, përse u përket vështirësive të përkthimit. Anën tjetër të saj e përbën ndikimi klasik në të shkruarit e Leopardit, çfarë nuk është thjesht e vetëm çështje stilistike, por përkundrazi ka të bëjë me bërthamën e një mendimi të pjekur filozofik. Ky element jo vetëm e detyron përkthyesin e kësaj poezie të jetë vigjilent gjatë përkthimit, por është edhe parakusht ndihmues – në mos i domosdoshëm – për t'i qëndruar besnik ligjeratës poetike.

Në një artikull të shkurtër në revistën *Biblioteca Italiana* të Milanos, me titull “Mbi mënyrat dhe dobitë e përkthimit”, francezja Madame de Staël polemizonte më 1816 domosdoshmërinë e përkthimit të veprave bashkëkohore romantike në italisht, e shqetësuar nga vonesa e përqaftimit të romantizmit europian prej letërsisë italiane. Në këndvështrimin e ashpër të zonjës De Staël klima letrare në gadishull vuante

prej kohësh ndikimin paralizues të traditës klasike. Ishte ajo traditë që e pengonte atmosferën romantike europiane, të modeluar mbi *physis*-in (Φύσις) e filozofëve parasokrarikë, të ndihej lirisht në vend tanimë si *ideal* i ndjeshmërisë njerëzore. Bashkëkohësi romantik i zonis De Staël trashëgonte nga Iluminizmi kokëfortësisht bindjen se arsyeja, e vetme përballë mbërthimit kuptimor të fenomenit, është e pamjaftueshme. Mendimi krijues artistik duhej t'u shmangej hijeve që zgjateshin nga klasicizmi i largët, ku ndrinte e gjithëpushtetshme arsyeja, për t'u çliruar nga konfliktet e tij romantike. Kjo situatë e bën më të kuptueshme se përse poezia “L'infinito”, e shkruar më 1819, reflekton qëndrimin e një mendimtari që nuk arriti asnjëherë të asimilojë shpirtin modern të kohës në të cilën jetoi.

Duke marrë në konsideratë këtë specifikë të përkthimit të *infinitit* leopardian janë përzgjedhur në këtë vëzhgim, për t'u ballafaquar me origjinalin, gjashtë variante të ndryshme në shqip, që paraqesin interes për qasjet e tyre ndaj origjinalit, si vijon: 1. Ernest Koliqi: “Pambarimi”; 2. Andrea Varfi: “Pafundësia”; 3. Lazer Shantoja: “Të pambaruemit”; 4. Nikollë Dakaj:

“Pambarimi”; 5. Arshi Pipa: “Pakufini”; 6. Aurel Plasari: *Pambarimi*”.

Atmosfera ligjëruese e vargjeve të para të poezisë hapet, jo pa qëllim, me kthimin në kujtesë. Poeti përkujton lidhjen e përhershme me një “kodër vetmitare” (ermo colle) dhe me “gardhin” (siepe), fort të dashur për të. Në thelb “natyra” në mendimin e poetit, ashtu si për filozofët e Antikitetit, përcakton realitetin e përhershëm prej nga rrjedh gjithçka. Për këtë arsye të sjellët në kujtesë nuk është kurrësi në funksion të ndonjë melankolie a ndonjë sentimente nostalgjik të një medituesi ndaj kohës së shkuar. Përkundrazi, brenda tij përndizet dhimbja e një dëshire të porealizueshme, të pambërritshme, në fakt të penguar. E shoqëruar me ankthin e papërmbushmërisë, që deduktohet në vijim, është pikërisht kjo dhimbje njerëzore – e njehsuar nga studiuesit si “*Sehnsucht*” – tipari dallues i mendimit bashkëkohor që nxjerr në pah ndikimin romantik në të shkruarit e Leopardit. Po ta trajtosh pa kujdes një tipar të tillë mund ta shfaqësh si gjendje nostalgjie ose ndjesie malli duke e zbehur shkakun e pikëllimit të poetit. Varianti 4 i shqipërimeve, për shembull, dallon për besnikërinë ndaj këtij tipari:

Përherë e desha këtë kodër vetmore
edhe këtë gardh, që larg e larg shikimit
hovin ia pret me pàm n'anë të përtejme.

Ndjesinë e të penguarit “të horizontit të përtejme”, pengesë që për poetin përbën burim dhimbjeje, pothuajse të gjitha variantet e përcjellin nëpërmjet “shikimit” dhe vetëm në variantet 2 dhe 3 propozohet “vështrimi”, për shembull te 2-shi:

Përherë e desha këtë breg të shkretë,
Si edhe këtë garth, që nga shumë anë
M'a ndal vështrimin e horizontit largë.

Përdorimi i “shikimit” në vend të “vështrimit” nuk është çështje thjesht teknike gjatë përzgjedhjes sinonimike nga përkthyesi. “Shikimi” e bën perceptimin vizual sipërfaqësor, fiton një lëvizje të qenësishme që mund të pengohet e deri të ndërpritet nga çasti në çast (“që larg e larg shikimit hovin ia pret”). Ndërsa në variantin 5 kuptimi i pengesës (“dell'ultimo orizzonte il guardo esclude”) vjen i përmbysur. Jo thjesht duke mos i qëndruar besnik vargut në fjalë, por dhe nga mohimi i të pamit nëpërmjet shmangies së emrit (substantivit) dhe shndërrimit të tekstit në situatë foljore:

Gjithmon e dashun që për mue kjo kodër
vetmitare e ky gardh që horizontin
s'e lën me e pà veç për një copë kah fundi.

Për poetin kapërcimi i një pengese të tillë nuk mund të ishte veçse imagjinar. Kjo pikë kulmon me ndryshimin e ritmit të brendshëm rrëfimtar të poezisë edhe si pasojë e një mospërkimi të strukturës sintaksore me atë metrike. Horizonti i përtejme ndalon së qeni pjesë e natyrës, “një copë kah fundi”, por shkrihet në të duke lënë pas çdo gjë të fundme. Ky kthim në origjinë, ku mbizotëron “heshtja mbinjerzore”, “e një qetë atje ku asht ma e thella”, realizohet si një ambient primordial, i cili vjen duke u zbratur nga caqet: çdo gjë e fundme kryen një rrotullim së prapi, gati metafizik, për t'ju qasur thelbit të vet material. Dhe gjithçkaja pushon në prehje.

Varianti 3 dallon për hijeshinë me të cilën ndërtohet përshkallëzimin drejt pambarimit duke mos humbur përdorimin stilistik të polisindetës (përsëritjes së lidhëzës “e”) në funksion të efektit të saj:

Por ndëjë e tue soditun, hapësina
të pambarueme përtej tij, dhe heshtime
përmbinjerzore, e t' thellë tejet qetë
un trilloj n'menden t'ime; ku mue zëmra
më merr gati trishtim.

Në variantin 4, pa i kushtuar rëndësi polisindetës, në vend të “qetë shumë e thellë” (*profondissima quiete*), përkthyesi ka ndërtuar enkas sipëroren e mbiemrit. Edhe pse nga ato që quhen “tradhti të vogla”, kjo zgjedhje e ruan kuptimin e vargut duke i dhënë emrit (substantivit) ngjyresë metafizike:

GJASHTË VARIANTET E “INFINITI” TË LEOPARDIT

Giacomo Leopardi L'INFINITO

Sempre caro mi fu quest'ermo colle,
e questa siepe, che da tanta parte
dell'ultimo orizzonte il guardo esclude.
Ma sedendo e mirando, interminati
spazi di là da quella, e sovrumani
silenzi, e profondissima quiete
io nel pensier mi fingo, ove per poco
il cor non si spaura. E come il vento
odo stormir tra queste piante, io quello
infinito silenzio a questa voce
vo comparando: e mi sovvien l'eterno,
e le morte stagioni, e la presente
e viva, e il suon di lei. Così tra questa
immensità s'annega il pensier mio:
e il naufragar m'è dolce in questo mare

PAMBARIMI Shqip: Ernest Koliqi

Prorë e pëlqeva kët kodrin' vetare
e kët gardh, qi i a ndalin shikimit
mâ të madhën pjes' të horizontit t'fundëm.
Por tue ndëjë e tue vrojtun, t'pambarueme
hapsina përtë saj dhe heshtina
mbinjerzore e 'i qetsi shum e shum t'thellë
përfytyroj me mënd e n'to mu zëmra
disi m'frigohet. E tue qën' se erën
ndëgjoj tue frushulit' nepër kto lëndë,
un rrij e krahasoj gjith' at heshti
t'pasosun me kët zâ dhe m'përkujtohet
amshimi, t'shuemet stin' dhe koha e sotme
gjallë, e zhurma e saj. Kështu mëndimi
mue n'at pamatësi kryekput më mbytet:
e mbytyja m'ash e ambël në kët dët.

PAFUNDËSIA Shqip: Andrea Varfi

Përherë e desha këtë breg të shkretë,
Si edhe këtë garth, që nga shumë anë
M'a ndal vështrimnë e horizontit largë.
Po kur qëndroj e vë rë, më paraqiten:
Hapsira pa mbarime tejë asaj,
E heshtje varri dhe qetsi pa fund:
Ku soje zemra ment *më drithëron*.
E unë si e ndiej të shushurisë
Ngadalëz erën nëpër gjethe e degë,
Qetsin pa fund me 'të e krahasoj:
Ahëre më kujtohet përjetësia,
Dhe koha e vdekur dhe e gjallë e sotme
E zëri i saj. E po kështu në këtë
Pafundësi venitet gjith' mejtimi:
Në det të tillë e mbytyja m'është e ëmbël.

TË PAMBARUEMIT Shqip: Lazer Shantoja

Daj e desha kët kodër vetmitare,
e njikët gardh qi të malbrëzit megjet
e mbrame bukur gjatë i a mbyll' shikimit.
Por ndëjë e tue soditun, hapësina
të pambarueme përtej tij, dhe heshtime
përmbinjerzore, e t' thellë tejët qetë
un trilloj n'mendjen t'ime; ku mue zëmra
më merr gati trishtim. E sikur erën
ndij kah fërshllon nëpër kta lisa, at heshtje
un t'pambarueme shkoj tue krahasuemun
me njikët zâ: dhe përkujtoj t'amshuemit,
edhe stinat e vdekuna, e të tashmen
e t'gjallë, e t'saj kumbon. Kështu mbytet
mendja e ime në kët pamatësi:
e m' u përmbytun në ket dët më kande.

PAMBARIMI Shqip: Nikollë Dakaj

Përherë e desha kët kodër vetmore
edhe kët gardh, që larg e larg shikimit
hovin ia prët me pàm n'ânë *të përtejme*.
Por, kah rrij e kundroj, të pambarueme
hapsi tej soje e heshtje mbinjerzore
e një qetë, atje ku asht ma e thella,
unë marr me mendë; e gadi-gadi zemrën
ma pushton friga. E, kah tue fërshellyem
erën ndigjoj përmes ktyne lëndëve,
unë at heshti t'pafund me kët fërshllimë
vë ball *për* ball: e m'kujtohet amshimi,
e stinët që kanë vdekë edhe kjo e tashmja
e gjallë e zani i saj. Kështu mendimi
m'rrin tue ba not në kët pamatunë;
e zemra m'heq me hupë në kët farë deti.

PÂKUFINI Shqip: Arshi Pipa

Gjithmonë e dashun qe për mue *kjo kodër*
vetmitare e ky gardh qi horizontin
s'e lën me u pa veç për një copë nga fundi.
Por kúr rrij e sodis, të pakufishme
hapsina *përtej tij dhe* mbinjerzore
heshtje dhe një qetë e páambarim:
trilloj ndër mend, kah zëmra gati m'dalet
prej frige. E kúr veshtrij eren qi tash
gjethët e pëm've bân me furshullue,
at heshtje pá mbarim shkoj me kto *zâne*
tue krahasue. E përkujtoj amshimin,
stinët e vdek'na e t'sotçmen, *ktë të gjallën*,
me jehonen e saj. Ashtu mendimi
te kjo pamatunë humbon e birret.
Dhe t'ambël m'vjen *të* mbytunit n'kët' dët.

PAMBARIMI Shqip: Aurel Plasari

Gjithnjë e desha këtë sukë të shkretë
dhe këtë gardh që m'ia pengon vështrimit
të fundmin horizont anë e matanë.
Por, tek kundroj këtu i ulur, stis
me mend hapësira pambarim tej tij
dhe heshtje mbinjerzore dhe qetësi
të thella sa në gji zemra mend ngrin.
Dhe erën ndërsa ndiej tek fërmon
mes gjethesh, zën' e saj e krahasoj
me heshtjen pa mbarim dhe përjetshmëria
më vjen ndër mend me motet që kanë vdekur
dhe këtë mot të gjallë e këtë kumbim.
Kështu mendimi mes këtij pambarimi
më bëhet fir edhe e ëmbël m'është
si anijethyer *të kridhem në këtë det*



Por, kahë rrij e kundroj, të pambarueme
hapsi tej soje e heshtje mbinjerzore
e një qetë, atje ku asht ma e thella,
unë marr me mendë; e gadi-gadi zemrën
ma pushton friga.

Gjendja e re ka si qëllim plazmimin e njeriut, në rastin konkret të vetë poetit, me amshimin pa kufi të natyrës, të realitetit të përhershëm material në të cilin ai do të prehet. Kjo mësohet prej vargut të shtatë, varg sa i diskutuar aq edhe i diskutueshëm:

“io nel pensier mi fingo, ove per poco/ il cor non si spaura”.

Në moshë krejt të re Leopardi ka asimiluar bukuritë e Antikitetit nëpërmjet mësimave të filozofisë, leximeve të ngulmëta në pasurinë e bibliotekës së trashëguar nga i ati. Mbi këtë bërthamë klasike është modeluar romantizmi i tij dhe janë kultivuar qëndrimet i tij qartësisht refuzuese ndaj nuancave romantike paragjyquese të Antikitetit dhe *kultit të tij të arsyes*. Veçanërisht në stilin e të shkruarit shfaqet kjo specifikë e romantizmit të tij. Në rastin konkret vargu i shtatë me të tetin lidhen përmes *sinalefës*, figurë stilistike e huajtur nga metrika greke, që shkrin zanoren fundore dhe atë nistore të dy fjalëve të njëpasnjëshme për t' i përfshirë brenda një rrokjeje të vetme (*“io nel pensier mi fingo, ove per poco / il cor non si spaura”*), çfarë sigurisht në gjuhët në të cilat përkthehet nuk është e thënë të ruhet.

Është vënë re, në të shumtën e lirikave të Leopardit, përdorimi i qëllimshëm i terminologjisë latine që, edhe pse në gjuhën italiane mund të mos ketë pësuar ndryshime sintaksore ose morfologjike, nga pikëpamja kuptimore nuk mund të thuhet e njëjta gjë. Folja *“fingere”*, në vargun e përmendur sipër, ka në shqip kuptimin: me u shtirë, më bë sikur, me përfytyrue. Varianti 6 e ka gjetur zgjidhjen në përdorimin e foljes *me stis* duke shmangur qëllimisht përdorimin artificial të pësorës së saj:

Por, tek kundroj këtu i ulur, stis
me mend hapësira pambarim tej tij
dhe heshtje mbinjerzore dhe qetësi
të thella sa në gji zemra mend ngrin.

Në latinisht kuptimi i parmë i foljes (fingo, fingis, finxi, fictum, fingere) jep: me formue, me i dhënë formë diçkaje, me gdhendë, me skalitë ose edhe me ndërtue. Duke kthyer në vëmendje kuptimin klasik të *physis*-it leopoldian, afërmendsh që pësorja e foljes sugjeron plazmimin, formësimin e unit poetik në diçka tjetër. Dhe kjo diçka nuk mund të jetë veçse materie, thelbi i pastër i vetë qenies që i kthehet *natyrës*: parimit të saj material. Përftesa stilistike e vargut në fjalë (*“io nel pensier mi fingo, ove per poco”*) është e rrallë për nga eleganca me të cilën kristalizojnë filozofinë e një poeti si Leopardi: kthimi në *physis*. Përkatësia ndaj natyrës përbën zanafillën e infinitit të tij. Në variantin 5 ky çast sublim, ndryshe nga origjinali, në dy vargjet e para është dhënë duke kulmuar me një përjetim ndërshtetor: *“veshtroj eren”, “gjethët e pëm've bân me furshullue”*:

E kúr veshtrij eren qi tash
gjethët e pëm've bân me furshullue,
at heshtje pá mbarim shkoj me kto zâne
tue krahasue. E përkujtoj amshimin,
stinët e vdek'na e t'sotçmen, ktë të gjallën,
me jehonen e saj. Ashtu mendimi
te kjo pamatunë humbon e birret.
Dhe t'ambël m'vjen të mbytunit n'kët' dët.

Ndërtimi i përvojës ndërshtetore nga përkthyesi, për të identifikuar përkatësinë e unit poetik ndaj *natyrës*, është një zgjidhje e diskutueshme, mbasi mbetet në funksion të përjetimit ndjesor. I njëjti koncept përkatësie për poetin është *princípioum*, parim arsyetimi filozofik.


Ashtu si *natyra* (*physis*), nuk duhet harruar që edhe *infiniti* të cilit i referohet vazhdimisht Leopardi është një koncept i huajtur prej filozofisë së Antikitetit. Apeiron

Vijon në faqen 8

Vijon nga faqja 7

(nga greqishtja e lashtë: ἄπειρον) është përkufizimi më i hershëm i *infinite* me të cilin Anasimandri i referohej principit që, krahas të qenit i pafundmë e i përhershëm (mos kufizim hapësinor e kohor), është i pakufizueshëm së brendshmi (ἄπειρα). Të qenit i përhershëm nënkupton njëkohësisht zanafillën dhe realitetin e fundmë të gjithçkaje që lind e vdes: “*më vjen ndër mend me motet që kanë vdekur / dhe këtë mot të gjallë e këtë kumbim*”, që ndizet e shuhet: “*mes gjethesh, zën’ e saj e krahasoj / me heshtjen pa mbarim dhe përjetshmëria*”. Në variantin 6 ndeshim pothuajse të gjitha cilësimet e ἀπειρον-it leopardian: mos kufizimin kohor “*përjetshmëria / motet që kanë vdekur*“, dhe atë hapësinor: “*heshtjen pa mbarim*”:

*Dhe erën ndërsa ndiej tek fërrmon
mes gjethesh, zën’ e saj e krahasoj
me heshtjen pa mbarim dhe përjetshmëria
më vjen ndër mend me motet që kanë vdekur
dhe këtë mot të gjallë e këtë kumbim.
Kështu mendimi mes këtij pambarimi
më bëhet fir edhe e ëmbël m’është
si anijethyer të kridhem në këtë det.*



Në tri vargjet e fundit të origjinalit del në pah aspekti i tretë, ai më thelbësori, i ἀπειρον-it leopardian: *moskufizimi së brendshmi i infinite*. Por këtë radhë ai nuk perceptohet tërthorazi nëpërmjet mbiemrave sinonimikë. Ky rol i besohet fuqisë shprehëse të figuracionit: “*Così tra questa / immensità s’annega il pensier mio: / e il naufragar m’è dolce in questo mare*”. I gjithë rrugëtimi metafizik i unit poetik udhëhiqet nga mendimi, nga fuqia e trillimit dhe imagjinata e autorit që përumb “*mes këtij pambarimi / më bëhet fir*”, pra duke u bërë pjesë e pambarimit e duke brendësuar të gjitha vetitë e tij, sidomos këtë aspekt të tretë. Mendimi *bëhet fir*, e njëkohësisht uni poetik bëhet i vetëdijshëm për gjendjen në të cilën i duhet të *kridhet* pambarimisht:

*Kështu mendimi mes këtij pambarimi
më bëhet fir edhe e ëmbël m’është
si anijethyer të kridhem në këtë det.*

Gjashtë variantet e përkthimit të së njëjtës poezi që u morën këtu në shqyrtim, bashkë me gjashtë a më shumë të tjerat, dëshmojnë që “*infinite*” i Leopardit jo më kot i ka joshur shqipëruessit dhe një numër i tillë përkthimesh të së njëjtës poezi nuk është pa rëndësi për të kuptuar evoluimin jo vetëm kohor, por mbi të gjitha gjuhësor, të artit të përkthimit në shqip.

MITI I FEMRËS NË POEZINË E VISAR ZHITIT

Dr. Yzedin Hima

Në “Letërsinë e penguar”, për shkak të rrethanave në të cilat kjo letërsi u nyjtua, figura e femrës është vërtetë një mit. Për shumë të burgosur femra ka qënë ylli polar që i udhëhoqi drejt lirisë përmes vuajtjeve mbinjerëzore të burgut. Femra, ose dashuria për të, ishte për të dënuarit i vetmi qëllim për të cilin ia vlente të mbijetoje në atë ferr, ku ajo që vlente më pak se hiçi qe jeta. Përballë brutalitetit, dhunës, shëmtisë, pisit, ushqimit të pështirë, mjedisit të ashpër mashkullor të burgut, figura e femrës qe si imazhi i oazit për njeriun që vrapon mes shkretëtirës. Urrejtja në burg qe me tepri, kurse dashuria mungonte. Vizatimi i një nudoje në një pllakë guri në mjediset e burgut të Spaçit u përjetua nga diktatura dhe krijoi një shtjellë më keq se shkrimi i një parrulle kundër saj. Linjat e saj të buta, arti i vizatimit, ishte në kundërshtim me parrullat, altoparlantin, britmat e kapterëve, dhunën e tyre mbi të burgosurit. Ajo nudo femre qe e kundërta e gjithçkaje që përjetonte i burgosuri në atë mjedis. Diktatura kujdesej pikërisht për të goditur aty ku dhembte më shumë, te dashuria, duke detyruar gratë apo të fejuarat e të dënuarve politikë që të divorcoheshin me ta. Duke ua këputur këtë lidhje me botën tej telave me gjëmba, dënimi dhe vuajtja merrnin përmasat që diktatura dëshironte dhe izolimi nga bota bëhej i plotë. Pas divorceve, i dënuari nuk largohej nga burgu as me mendje, se s’kishte se ku të shkonte. Në librat me kujtime nga burgu janë të shumtë shembujt kur të burgosurve u njoftohej divorci me femrat e tyre, sikurse pati shumë e shumë raste kur femrat e të burgosurve u shndërruan në torsa dhembjeje në pritje të burrave të tyre, që dënoheshin dhe ridënoheshin nga diktatura më diabolike në botë. Diktatura qe e vetdijshme që t’i drejtonte ndëshkimet e saj jo vetëm te trupi, por më shumë te shpirti, sikurse nënvizon Mishel Foucault.

Miti i femrës në tekstet poetikë të Visar Zhitit është po kaq i pranishëm sa miti i poezisë. Femra dhe poezia në tekstet e tij shpesh shndërrohen në njëra – tjetrën. Krijimi i poezisë i ngjet zhvishjes së femrës, ku zbulohet forma magjepse jo vetëm e saj, por edhe e poezisë: *E si të mos të të vijë keq / për ato duar që të zhvishnin / nga kotësia e rrobave prej mjegulle / duke të bërë lumë pa brige / ndërsa gishtat e dridhjes / pikonin yje, yje blu, ar dhe bardhësi yjesh...*

Një krijues si Visar Zhiti, në gjendje permanente mahnje, arrin të estetizojë edhe burgun, këtë ferr, jo më femrën që në analizë të fundit, nga pikëpamja e formës është vërtetë një vepër arti. Në tekstin e poezisë “Duart e

keqardhjes”, poezi e shkruar në burg, Visar Zhiti vizaton format artistike të femrës që duart e tij njëkohësisht e zhveshin dhe e krijojnë: ... *e shtrirë, lakurige, / reliev hyjnor, e butë dhe rënkujësë / vazhdimisht braktisëse formash / bëheshe hapësirë e hutuar, / zjarr brenda akullit, borë që bie në ëndërr...*

Dhe pas gjithë kësaj dehjeje estetike teksti sjell një pamje krejt tjetër. Duart që aq bukur zhvishnin, zbulonin, modelonin e krijonin, mbërthehen padrejtësisht në pranga, pikërisht pse krijuan: *Dhe kumbonin duart e frymëzuara / mbi trupin tënd / si një piano. / Ato duar që i arrestuan / dhe u vunë pranga të rënda sa e shkuara pa ty...* Ah, ikën duart e mia, vetëm / Vijnë tek ty si dy lejte të trembur./

Në tekstet poetikë të Visar Zhitit femra mitizohet jo thjesht për hiret e saj, por edhe për virtytet. Gratë e të burgosurve politikë, sikurse shkruam edhe më lart, në më të shumtën e rasteve kanë ditur të mposhtin diktaturën pikërisht me virtytet e tyre, “material” shpirtëror i paasgjueshëm nga asnjë lloj dhune. Në një tekst poetik pa titull të Visar Zhitit, gruaja e të burgosurit shihet si një pemë që qëndron buzë humnerës. Gjethet e saj janë të heshtura, nuk

mund të fëshfërijnë. Nga pikëllimi këto gjethe bien e bien. Vjeshta është stina e tyre e

përhershme, si stinë e ndarjes, e pikëllimit. Gruaja është pemë e brishtë, e rrezikuar: *Gruaja e të burgosurit / është pemë / buzë humnerash / gjethe të heshtura / nga pikëllimi i saj / bien dhe mbushin / botën.*

Uni poetik trishtohet shumë nga shpërdorimi që i bëhet së bukurës, trajtimi jonjerëzor i femrës, fyerja e dinjitetit të saj, mungesa e respektit për të. Në tekstin e poezisë “Në kullën e gruas së bukur” poeti Visar Zhiti vizaton me dhembje portretin e saj të poshtëruar nga statusi i saj i ulët në familje. Poezia është shkruar në vitin 1979 në fshatin Vilë të Kukësit, ku autori punonte si mësues. Është një himn, por edhe trishtim për femrën, për të bukurën e traumatizuar: ...*Në odën e madhe, shtrirë mbi qilimat e tu, / dëgjoj i ngrysur / hapat e tua prej ballade. / S’e di nga e kuptova, ti je dëshpërimisht e bukur, / nga qëndismat mbase. / Futesh vetëm për të na larë këmbët, / fytyra jote çdo mbrëmje mbytet nëpër legenët. / Trarët e kullës ndiejnë dhembje / si atëherë, kur i ndanë nga pemët.*

Propaganda për emancipimin e gruas në diktaturë ishte qesharake. Pa u emancipuar e gjithë shoqëria, nuk mund të ketë emancipim të femrës. Në diktatura as që mund të bëhet fjalë për shoqëri të emancipuar, ku



Portreti nga Ina Lajthia

mungon kriteri numër një për këtë proces, liria: *Po unë a të pranoj të m'i lash ti këmbët? / A nuk do më zërë mallkimi i krojeve? Vështrimi im si unazë që bie në ujë, / të ra në zemër / dhe u hutove. /*

Janë dy pyetje retorike që flasin për refuzimin e këtij shërbimi që i bëhej mikut si nderim, duke poshtëruar krijesën delikate dhe të bukur, femrën. Vargu “*vështrimi im si unazë që bie në ujë të ra në zemër*” ndërtohet nga një krahasim: *vështrimi im si unazë që bie në ujë* dhe një metaforë: *të ra në zemër*. Parë në rrafshin estetik krahasimi është i gjetur dhe origjinal. Fjala *unazë* mbart tërë ngarkesën e semantikës estetike dhe semantikës kuptimore: *vështrimi* është tepër i rrallë dhe i vyer si unaza, si ari. Rënia në ujë e unazës është e butë, por disi dramatike, nga frika e humbjes. Metafora *të ra në zemër* shkakton hutimin e femrës, pra ajo e merr mesazhin dhe e pranon atë. Ajo, ndonëse me një status përbuzës ende nuk e ka humbur ndjeshmërinë, sikurse edhe bukurinë. Uni poetik revoltohet duke refuzur nderimin, (larjen e këmbëve), që njëkohësisht është çnderim. Duke e mitizuar femrën ai bën thirrje për sjellje të qytetëruar ndaj saj: *Largomani legenin - këtë verbëri të turbullt! / Cohuni në këmbë ju shkëmbin!* / *Që të mos mbeten i egër bëjini vend të Bukurës, / Perëndeshës së jetës!*

Në këto vargje dallohet qartë mitizimi i femrës si rezultat i destruksionit të mitit të saj nga zakonet dhe kodet shqiptare. Ajo thirret Bukuri me B- të madhe dhe Perëndeshë e jetës.

Më lart folëm për vizatimin e një nudoje në burgun e Spaçit, e cila solli tronditjen e krejt kampit, edhe të të burgosurve, edhe të komandës, natyrisht në sens të ndryshëm. E kanë përmendur në kujtimet e tyre këtë fakt edhe shkrimtarë dhe artistë të tjerë të burgosur, ndërsa poeti Visar Zhiti e sjell në mënyrë artistike në tekstin e poezisë së tij me titull “Gruaja komplotiste”: *Dy sy të mëdhenj... / ...buzët, / ...supet e zhveshura të mermerta... / barku, fundi i barkut... / Lakuriq, pa turp / para nesh qendronte jeta. / Në shtjellën e krijuar kemi dy trazime: a.Trazimi i të burgosurve, i cili ishte shpirtëror, estetik, mendor: Një grua / doli nga muri i burgut...buzëqeshte... / Ajo u dha shpirt gurëve, / gurët nuk ishin më heshtje. / Efekti i nudos te të burgosurit, te uni poetik është krejt njerëzor: Buzët e saj / pakëz të hapura / na mërmëritën fjalët e dashurisë së parë. / Këmbët tona të zbathura / shpikën vezullueshëm një bulevard. /*

Duke qënë njerëzor, shkakton edhe zgjimin instiktit dhe kërkimit të lirisë. Në tekst përdoret grotesku për të dhënë përmasat e pështjellimit shpirtëror të të burgosurve: *Desh filluam një kryengritje / mbas pak. / Erdhën përforcime, / Se nga doli një tank. /*

b.Trazimi i diktaturës, i cili ishte trazim idelogjik, instiktiv mbrojtës nga e bukura, nga arti si agresion. Poeti përdor sërish groteskun për të vizatuar pështjellimin e diktaturës: *Filluan reprezaljet. / Të gjendet piktori që organizoi komplotin kundra shtetit / Dhe kjo grua agjente që u hodh me parashutë mbi kamp / të pushkatohet. / Teksti mbyllet me dy vargje, ku nënvizohet qartë se frymëzimi artistik është frymë hyjnore, sikurse edhe shpresa për liri: Vërtetë / nga qiejt erdhi, nga lart... /*

Në tekstin e poezisë të titulluar “Zemër...”, e cila është shkruar në burgun e Qafë-Barit në vitin 1983, Visar Zhiti thotë: *Nxitojnë muzgjet, / Nxiton dhe ti që të arrish më përpara se muzgjet. / Ecën në këmbë, / sepse s’lejoheh takimet natën. Nxiton, / që të vesh ti më parë se mbrëmja. /*

Paralelizmi figurativ ku muzgjet dhe gruaja pranëvihen në lëvizjen e tyre në ngjitjen drejt maleve (në fakt muzgu nuk ulet, por ngrihet), parë në rrafshin semantik sjell figurativisht sakrificën e femrës që sfidon kohën në të mirë të burrit të saj të burgosur. Në vargjet e fundit të tekstit gjejmë dy metafora: *dita shtanget, dita ngrin*, të cilat sjellin imazhin poetik se edhe koha ndalet në respekt të altruizmit të femrës dhe synimit fisnik të saj për të takuar burrin në burg: *Dhe dita shtanget, / Ngrin. / Të të ty të ecësh përpara, / që të të vijë nga pas. /*

Në një tekst poetik, i titulluar “Mirënjohje”, i shkruar në Spaç më 6 tetor 1982, mungesa e femrës në burg është shumë më torturuese se të gjitha mungesat bashkë. Një vajzë kalon përbri burgut dhe shtang një burg të tërë. Burgu bëhet më burg: *...Të shohim, / të shohim, / por s’të ndjekim dot, / veç me sy...Na u plasaritën sytë si xhamat... Zbathur shkelim mbi xhamat e syve tanë / dhe s’të arrijmë e s’të arrijmë dot... / Metaforat befasuese si: na u plasaritën sytë (plus krahasimin *si xhamat*), *zbathur shkelim mbi xhamat e syve tanë*, hapim mjegullat (plus krahasimin *si perdet*), *shtyjme kullat e rojeve, shtyjme robërinë apo malet*, apo krahasimi: *gjethet bien si puthjet tona të thara në rrugë,**

vizatojnë me dramacitet e tragjizëm mungesën e femrës, natyrisht e vizatojnë femrën si një qenie mitike. Teksti mbyllet me një varg ku krahasimi i peshës së prangave me peshën e gurëve të varreve flet në të mirë të argumentit se mungesa e femrës në burg është ndëshkim që i drejtohet njëkohësisht edhe trupit edhe shpirtit. Dhe ky ndëshkim i padrejtë vazhdon me dhjetra vite, apo edhe një jetë të tërë. Prania e femrës rastësisht përbri burgut bën që: *Prangat rëndojnë më shumë se gurët e varreve. /*

Visar Zhiti, pas daljes nga burgu, u dërgua të punonte si punëtor në fabrikën e tullave në qytetin e Lushnjes. Në tekstin e poezisë “Gratë e fabrikës së tullave” gjejmë këto fjalë dhe shprehje çelësa: *gra, lule, sy, rimel, peizazhet e trishta, stivosin tulla, bluzë qiejsh, enigmë, dallëndyshe, duart e dashurisë, shtyjne njera tjetrën si hallet, si duaj gruri, balta, unaza, poezi. Është një tekst si vijim i tekstit të poezisë “Në kullën e gruas së bukur”. Femra, përherë një mit për poetin Visar Zhiti, punon në një fabrikë ku puna është tejet e vështirë edhe për meshkujt. Në këtë mjedis feminiteti i saj vritet çdo ditë: *Gra, të cilave / askush mund të mos u ketë dhënë lule në jetë / ... punojnë stivosin tulla nëpër rafte metalike... / ...Balta nëpër duar / e mbuloi unazën / bashkë me retë që mbuluan hënën. / U lodhën gratë, / u ulën së bashku tufë. / Si duaj gruri ngjajnë- rënë nga qerrja rrugës... /**

Balta që mbulon unazën dhe retë që mbulojnë hënën pranvihen si dukuri që përbaltin kujdesin dhe errësojnë të bukurën. Ndërsa krahasimi *Si duaj gruri ngjajnë- rënë nga qerrja rrugës*, sjell në kujtesën tonë trajtimin jo dinjitoz të gruas. Në tekst ndërtohet edhe ëndrra e çdo femre, të vishet bukur e me dinjitet: *...të kesh një bluzë qiejsh me një papjon të zi si enigmë dallëndyshe, / një fund bluxhins, i çarë, sikur e çanë duart e dashurisë që u çmend. /*

Në tekst, krahas mungesave që vijnë nga varfëria materiale, e njohur kjo në vitet e diktaturës, vihet re edhe varfëria shpirtërore e burrit: *Gra, të cilave / askush mund të mos u ketë dhënë lule në jetë*, / Nëse ishte e pamundur të falje *një bluzë qiejsh*, një tufë me lule apo një lule gjendej kudo. Në tekstet poetike të Visar Zhitit femra është mit, jo vetëm si rrjedhojë e mungesës së saj, por edhe si rrjedhojë e pranisë së saj: *Me vetëtimën / a mund të lësh takim? Si vetëtima je ti, si vetëtima / kaq bukur e frikshme. / Shkrepëtin dhe mbush me dritë të harbuar / hapësirën e tjetrit. /* Krahasimi *si vetëtima* dhe vargu *kaq bukur e frikshme* mbartin një ngarkesë të fortë semantike edhe në rrafshin estetik, edhe në rrafshin kuptimor. Vetëtima bën dritë, shfaqet befas, shfaqet e rrezikshme, të godet krejt si bukuria (edhe ajo bën dritë, të godet, është e rrezikshme). Vargu *kaq frikshëm e bukur* me mjete mjaft të kursyera vizaton bukurinë e femrës. Dihet, kur një fenomen, një dukuri, në këtë rast bukuria e femrës, shfaqet në përmasa të mëdha dhe me një intesitet të pazakontë, të frikëson. Në tekstet poetike të Visar Zhitit femra vizatohet me të gjitha hret e saj fizike dhe shpirtërore, herë- herë me natyralizëm, shpesh te estetizuara deri në mit. Visar Zhiti mungesën e femrës e shikon si mungesë të gjysmës më të mire të burrit, por edhe të gjysmës së domosdoshme të tij, pa të cilën burri është i papërsosur, i pamjaftueshëm, i frustuar. Prania e saj e bën burrin më të bukur, më njerëzor, më të mirë. Uni poetik gjen te femra gjerat e vogla që na mbushin jetën e përditshme, por edhe gjerat e mëdha, me të cilat burri merr dimesionin e botës. Në tekstin e poezisë “Nga kokra e qershisë deri te universi” thuhet: *Si një fryt gjithë lëng / gati të bjerë nga dega, / Ti mbushur tërë dashuri je / ja ashtu si buzët e tua gjysmë të hapura, / si gjinjtë rënkimtarë / si trupi yt i kaltër / që valvitet nëpër dallgë ere, / rrotullohet, rrotullohet / dhe ajri nxjerr shkëndija nga fërkimi me Ty. /*

Vargu i fundit na shtie në mendje se Visar Zhiti beson te e bukura verbërisht, me sigurinë se e bukura është gjithmonë e vërtetë, ndonëse e vërteta nuk është gjithmonë e bukur. Bukuria jepet jo e ngrirë, por në lëvizje, në veprim duke jonizuar edhe objektet me shpirt edhe ato pa shpirt si ajri.

Mitizimi i femrës kap kuota të larta në vargjet e mëposhtme, po tek i njëjti tekst: *Ti çahesh për të më futur mua. / Që të më shpëtosh nga humnerat e hiçit /*

Ndërsa dy vargjet në vijim, uni poetik përsosjen e tij edhe fizike edhe shpirtërore e shikon si rrjedhojë e daltës së dashurisë, daltë e cila u përdor mjeshtërisht nga duar gruaje: *M’i hoqe gjithë pjesët e tepërta dhe le / Fytyrën e njeriut tek unë. /*

Poezia e Visar Zhitit është “thuruar” me fije humanizmi sikurse shkruan tek teksti i poezisë me titull “Trokitje patjetër”: *E jeta që s’mjafton për dashurinë... e tmerrshme të gjesh kohë / për urrejtjen. /*

NJË ROMAN I RI SA NJË VETËTIMË...

Stefan Çapaliku

Një vit mbas botimit të romanit “Extra time ose veltja ime e dytë” po nga shtëpia botuese “Gjergj Fishta”, Durim Taçi vjen me romanin tjetër të rëndësishëm “Një prani në ikje”.

Ky roman si një vijim koskuent i një narracioni novator në gjuhën shqipe është një kryevepër e letërsisë sonë bashkëkohore. Romani thellon në pikpamje stilistike aventurën estetike të “Extra time” duke na propozuar një tjetër stacion të lumtur, ku mund të ndalemi dhe të shijojmë dramaticitetin e një realiteti të ashpër dhe të treguar mjeshtërisht.

Me këto dy libra Durim Taçi dëshmohej si një prej krijuesve europianizues të letërsisë sonë, që e kthen atë në kohërat e arta, kur ishte duke ecur paralel dhe me dinjitet përkrah asaj që shkruhej në Përrëndim.

“Një prani në ikje” është një vepër bashkëkohore jo vetëm nisur nga përmbajtja, por edhe nga mënyra e strukturimit dhe rrëfimit. Vepra na dëshmon se përmbajtjet e reja të çojnë natyrshëm drejt formave të reja.

Edhe “Një prani në ikje”, është i shkruar gjithashtu në dy gjuhë, italisht e shqip, siç janë shkruar edhe disa nga veprat e tjera të tij.

Për ata që s’janë ende familjarë me autorin I bëj me dije se Durim Taçi (1964) studioi filologji e kinematografi në Tiranë dhe filozofi në Milano, përkthyes i mbi pesëdhjetë titujve letrarë, autor i librave të shumtë të botuar në Shqipëri. Ka lënë Tiranën në vitin 2000 dhe jeton në Bergamo, Itali. Pas një kontributi ne fushën e leksikografisë, bashkautor në Primissimo Zanicheli di Accoglienza (2007), fjalor italisht-shumëgjuhësh, ka bërë debutimin e tij në narrativën italiane me romanin Codice Kanun (Edizioni dEste, Milano 2016), nderuar me çmimin ‘Montefiore’ për merita të veçanta artistike. Më pas botoi Extra Time, vetja jote e dytë, (Botimet Fishta, Tiranë 2019 dhe Mimesis Edizioni, Milano 2020), një tekst “mitobiografik”, i frymëzuar nga idetë e shkollës milaneze Philo - Praktika Filozofike, të cilën e ka frekuentuar.

Libri është pjellë e një eksperiencë kurrë të ndodhur më parë, siç qe goditja që njerëzimi mbarë mori nga pandemia e Covid-19, parë nga qendra më problematike dhe vdekjeprurëse, siç qe Bergamo e pranverës së këtij viti. I ndodhur pikërisht atje, autor na e përshkruan situatën me një aftësi të mrekullueshme shtëgtimi nga jashtë Brenda dhe nga Brenda jashtë, duke i dhënë atij reliteti të egër herë pamje të lugëta e herë të mysta.

I mbyllur në shtëpinë e vet me trup dhe i hapërdarë nëpër Europë me mend ai na fton të rezistojmë si burrat deri në faqe të fundit.


Një prani në ikje

ROMAN



DURIM TAÇI

BOTIMET FISHTA



Mbi vëllimin e ri poetik të Rudolf Markut, "Rrathë të brendashkruar"

AGON ME REFLEKSET E SAMIZDATIT

nga Gëzim Basha

Rrathë të brendashkruar, ashtu si të gjitha botimet e mëparshme të Rudolf Markut, sjell jehona verbale, sonike dhe ideore prej traditës më të mirë të poezisë refleksive, pa cak gjuhe a kulture. Libri që marrim në dorë ka peshën e një modeli të atletizmit gjuhësor dhe estetik, është një *tour de force* aludimesh dhe aluzionesh, i ndërton kuptimet e veta me zhdërvjelltësi stilistike, ngaqë autori prej pesë dekadash e koncepton shkrimin e poezisë jo si pauzë meditimi, por si një proces të pandërprerë navigimi në galaksinë e mundësive shprehëse.

I

Leximi i poezisë, pavarësisht lenteve personale, përherë nis me një kuriozitet standard, marrëdhënien e tekstit me traditën, më saktë konceptin e autorit mbi traditën letrare. Rudolf Marku hyn ndër autorët tanë të paktë i cili qysh në fillimet e tij letrare në fillimin e viteve '70, duke refuzuar prerë parimin socrealist të frymëzimit nga jeta, ka praktikuar me sukses leximin për inspirim, ambicie jo fort e lehtë në një kohë kur direktivat zyrtare urdhëronin me ton imperativ shmangien e ndikimeve të huaja, frymëzimin nga jeta dhe pasqyrimin me vërtetësi të realitetit.

Dy dekadat e para të krijimtarisë së Rudolf Markut të kujtojnë vargun e Preç Zogajt, “qëlloi stinë e thatë për poezinë”, përkohë me histerinë shurdhuese, anakronike dhe antihistorike ushtruar prej policisë politike në letërsi dhe arte. Vitet '70-'80 të shekullit të kaluar ishin vite kur atakohej çdo prirje për diversitet estetik, një aksion politik donkishotesk i cili synonte të pamundurën, kthimin e letërsisë shqipe në kohën e *mimesis*-it.

“Te Platoni dhe Aristoteli, - thotë profesor Paul Fry i Yale University, - poezia konsiderohej imitim i realitetit, ngaqë grekët nuk patën trashëguar pika të tjera referimi. Prej teoricienëve latinë, Kuintilian dhe Ciceron, ideja e *mimesis*-it u transformua në *imitatio*, jo me imitim e natyrës, por imitim i modeleve letrare paraardhëse”. E tepërt të thuhet se me nocionin imitim Paul Fry nuk presupozon epigonizmin vulgar, por pikat e referimit, ato koordinata estetike që përcaktojnë pastaj karakterin e krijuesit.

Shqipëria e dy dekadave të para të krijimtarisë poetike të Rudolf Markut kërkonte të injoronte këtë ligjësi të letërsisë, izolimi politik impononte një gjendje mendore të nderë, e cila shkaktonte një lloj autizmi kulturor masiv.

Shumicën refleksi i mbijetesës mentale e drejtonte nga programet e huaja televizive, ndërkohë që një numër i kufizuar, kryesisht shkrimtarë, praktikonin *samizdat*-in, praktikë gjerësisht e njohur në BS dhe vendet komuniste të Europës Qendrore, – qarkullimin përmes shumëfishimit me makinë shkrimi a shkrim dore të përkthimeve nga autorë të huaj, shumica edhe formalisht të ndaluar.

Mund të duket e habitshme, por, sado e izoluar, Shqipëria pati hibridin e vet të *samizdat*-it: Ismail Kadare e lexoi dorëshkrimin e shaptilografuar të *Doktor Zhivagos* në një apartament të braktisur të Moskës, ndërkohë që Dritëro Agolli, teksa kthehej nga studimet, flaku në det fletoren ku kishte kopjuar me shkrim dore poemën e Tvardovskit, *Vasili Tjorkin në botën tjetër*. Visar Zhiti, përpara arrestimit për motive politike, mbante në çantën e mësuesit vjershat e Jevtushenkos; Zija Çela kopjonte me shkrim dore variantin frëngjisht të romanit të Sabatos, *Mbi heronjtë dhe varret*; vetë Rudolf Marku përkthente *Të vdekurit* e Xhojsit dhe autorë të tjerë të modernizmit anglofon, si T. S. Eliot, E. Pound apo W. Oden, ndërkohë që Preç Zogaj bënte diçka edhe më të çuditshme: transkriptimin e emisioneve poetike të Radios Italiane. Në një vend si Shqipëria socialiste, ku në çdo dekadë pushkatoheshin apo vareshin në litar poetë lirikë, përpjekje të tilla, edhe pse rrezikonin çmim të rëndë, ishin mundësia e vetme për emancipim estetik në kohën e paranojës, për konceptimin e traditës jo sipas rekomandimeve politike, por sipas afiniteteve dhe ndjeshmërive personale.

II

Poezitë e Rudolf Markut, pavarësisht embrioneve tematike, realizohen si fryt i atij procesi të pashmangshëm për të cilin Harold Bloom-i përdor termin *agon* dhe e përkufizon si një moment tensioni a përplasjeje të nisur në shtresën instinktive të psikikës mes poetit aktiv dhe mjeshtrit paraardhës. Rudolf Marku në *agon*-in e vet konfronton modele letrare jashtë traditës së imponuar. Pavarësisht izolimit kulturor të Shqipërisë, modelet estetike të inspirimit të tij vijnë si reflekse prej modernizmit të anatemuar europian, të cilat, pavarësisht izolimit, hynë edhe në Shqipëri me *samizdat*-in tonë të ndrojtur e *sui generis*. *Simulacrum*-i poetik i këtij autori vërtitet midis esencializmit dhe përkujdesjes së përkorë ndaj imazhit.

Duke qenë se në poezitë me motive nga historia apo mitologjia Rudolf Marku shfaqet qartë si esencialist kavafian, – një poet të cilin e ka shqipëruar jo vetëm në nivel kuptimor, por edhe në shtresën e strategjive retorike, – mundësia e *agon*-it të provokuar nga Aleksandriani i madh e bën leximin përmes prizmit të influencave dhe kapërcimit të tyre, pak të thuash, atraktiv. Autori shpesh e mënjanon ekzuberancën gjuhësore në favor të një asketizmi shprehës, i jep poezisë së tij teksturën e një proze të dëshmisë, në dukje me stil *a-poetic* e prapë thellësisht ritmike, me kadenca jo vetëm sonike, por edhe kuptimore. Ambicioz dhe autentik njëherësh, Rudolf Marku e përqendron vëmendjen ndaj detajit, por dhe e kërkon origjinalitetin te synimi për të dislokuar tensionin a paradoksin e momentit historik duke e veçuar idenë si element strukturor, shpesh në vargjet përmbyllëse. Konsideroni strofën-epilog të poezisë *Nata e fundit e Ovidit në Romë*:

Nesër nis udhëtimin për në vendin e barbarëve,

Tani që barbarët nisen të dynden në drejtim të kundërt, drejt qendrës,

Sepse barbarët e dinin prej kohësh,

Kur Roma i përzë poetët e vet

Është koha e duhur për t'i rënë perandorisë.

Te poezia *Të kryqëzuarit zbresin Golgotës*, ku farsa përshkruhet me rekuizitën e sublimes, procedon krejt ndryshe; duke luajtur me tonin, i krijon vetes hapësirë për të shtuar elementet parodike të pastishit; e zgjeron përmasën kuptimore të poezisë, por pa e nënvizuar idenë si element strukturor. I mbetet lexuesit plotësimi i rebusit:

Të kryqëzuarit zbresin Golgotës...

...Nuk i njeh askush. Pandehën se ishin Krishti.

I merr malli për një fishkëllimë

A një kurore gjembash. Janë të vetmuar

Tek zbresin Golgotës. Ç'të bëjmë, ç'të bëjmë me jetën tonë?

Historia për të shpesh është rebus, ngaqë Engjëlli i Historisë – ajo kroki e Walter Benjaminit – e humbet natyrën prej *spiritus familiaris*, nuk bindet lehtë për ta udhëhequr labirinteve gjarpërore të historisë. Më shumë se sa guidë, “Engjëlli i Historisë” për Rudolf Markun shfaqet si gardian në pritë – është një engjell pagojës:

Vetë Engjëlli i Historisë të ka zënë pritë,

Me plagët e përhershme – masakra të Fatit,

Engjëlli i Historisë nuk na e thotë as vendin se ku jemi, O vendi im!

Në një numër jo të vogël poezish Rudolf Marku i lë vend hapësirës fizike, peizazheve, por të defamiljarizuara për të reflektuar tërë makthet dhe horrorret e botës urbane, ku absurdi ekzistencial shpesh shfaqet si rrezik imediat dhe i panegociueshëm, ku transformimi është shpesh trajtë e tehuajëzimit. Si për të shmangur rrezikun e mondanitetit vanitoz, këto lloje lirikash i konstruktton me renditje detajesh të para me syrin e ftohtë të një reporterit neutral:

Milano. Alpet nuk janë larg prej këtu,


Por mjegulla rri fshehur, e ndrojtur, e bardhë,

Në shoqëri ujqërish që i ulërijnë Hënës

Presin veç çastin për t'iu sulur qytetit.

III

Duke e adaptuar historicizmin si parim dhe kusht *Sin Qua Non* debati zyrtar mbi një histori gjithëpërfshirëse të letërsisë shqipe, edhe pse me një trajektore kohore disadekadëshe, ka mbetur ende në terma kuantitativë – shtim apo përjashtim autorësh, kryesisht për arsye joletrare. Leximi në dorëshkrim i librit të fundit të Rudolf Markut, *Rrathë të brendashkruar*, të përforcon bindjen për nevojën e ngutshme të një aparati kritik krejt tjetër: hartimin (më në fund) e një historie të letërsisë shqipe jo më si kënd monokrom emulacioni, por si një kanon korentesh estetike. Në një histori të tillë letërsie roli dhe arritjet e Rudolf Markut si një forcë emancipuese në letrat shqipe do të duhej të zinte një vend të merituar.



NGŪGĨ WA THIONG'O: Jam një luftëtar i gjuhës

Intervistë me Nanda Dyssou

Ngũgĩ Wa Thiong'o është një shkrimtar, studiues, dhe aktivist shoqëror kenian i njohur në të gjithë botën. Vepra e tij e larmishme përfshin romane, tregime, drama, artikuj, ese, dhe poema, të cilat janë përkthyer në mbi gjashtëdhjetë gjuhë. Si Profesor i Merituar i Letërsisë Krahësuese në UC Irvine, ai ka marrë një numër të madh çmimesh dhe njëmbëdhjetë doktorata nderi. Ngũgĩ i referohet vetes si një 'luftëtar i gjuhës' për shkak të përpjekjeve këmbëngulëse që vazhdon të bëjë për njohjen e gjuhës së tij amtare, Gikũyũ, dhe gjuhëve të tjera të lëna mënjanë.

Librat e tij përfshijnë romanet *Petale Gjaku*, për të cilin u dënua me burgim nga qeveria keniane në vitin 1977, *Një Kokërr Gruri* dhe *Magjistari i Sorrës*; kujtimet, *Ëndrra në Kohë Lufte* dhe *Në Shtëpinë e Përkthyesit*; si edhe esetë, *Dekolonizimi i Mendjes*, *Diçka e Grisur dhe e RE*, si edhe *Globalectics*.

Krahas shkrimtarit tonë të rangut botëror, Ismail Kadare, Ngũgĩ Wa Thiong'o ishte edhe këtë radhë, në tetor të vitit 2020, një nga kandidatët e mundshëm për fitimin e Çmimit Nobel në Letërsi.

Intervistë me rastin e marrjes së Çmimit LARB/UCR për Arritje në Krijimtarinë Artistike të Jetës, në vitin e dytë të organizimit të tij.

A ju kishte shkuar ndërmend në moshë të re se do të bëheshit një autor i njohur në shumë vende të botës dhe se tregimet tuaja për Kenya-n do të përktheheshin në gjashtëdhjetë gjuhë të huaja?

Jo, kurrë, madje, as edhe se do të bëhesha shkrimtar. Lufta që bëhej, për të shfrytëzuar çdo mundësi që mund të të jepej për t'u shkolluar, ishte shumë e madhe. Konkurrenca për të kapur një vend, në ato pak shkolla dhe kolegje që ekzistonin, ishte shumë e ashpër. Që nga shkolla fillore deri në kolegje jepnim provime vjetore çdo dy vite. Një rast i dytë, zor se mund të të jepej. Po të zbrisje nga treni, për çfarëdo arsye, vështirë se mund ta kapje atë përsëri. Por, unë gjithmonë kisha dëshirë për të lexuar. Siç e kam rrëfyer edhe në kujtimet e mia, *Në Shtëpinë e Përkthyesit*, pikësynimi im, që nga momenti kur u futa për herë të parë në një librari, ishte që, një ditë të isha në gjendje t'i lexoja të gjitha librat që ekzistonin në botë. Realiteti nuk vonoi të m'i priste krahët e këtij pikësynimi, megjithëse dëshira për të lexuar mbetet akoma e gjallë.

Cili është, sipas mendimit tuaj, roli juaj në bashkësinë e krijimtarisë letrare në këtë fazë të karrierës suaj?

Unë tashmë jam një luftëtar i gjuhës. Dua që t'iu bashkohen të gjithë atyre personave kudo që janë në botë dhe që luftojnë për gjuhët e lëna mënjanë. Asnjë gjuhë nuk lihet kurrë mënjanë nga bashkësia që e ka krijuar atë. Gjuhët janë si veglat muzikore. Kurrë nuk mund të thuash, le të ketë vetëm disa vegla muzikore në botë, ose le të ketë vetëm një tip zëri për të gjithë këngëtarët që interpretojnë.

Botimet e para të suksesshme i patët në rininë e hershme. Drama juaj e parë, *Oshëinari i Zi*, e shkruar në vitin 1962, u botua një vit më vonë. Më pas erdhën dy romanet e para - *Mos Qaj, Fëmijë* (1964) dhe *Lumi në Mes* (1965) – që u pritën shumë mirë nga kritika kur ju ishit student në vitin e dytë të kolegjit. A ishit i shqetësuar se nuk do të mund ta përsërisnit suksesin që patët me të mbushur të njëzetat?

Në të vërtetë, për shumë vite, romanet e para i konsideroja si punën e një praktikanti. Kështu që, pavarësisht nga romanet dhe drama që ju përmendët, si edhe përafërsisht tetë tregime dhe gjashtëdhjetë shkrime gazetarie, unë e kisha të vështirë ta quaja veten shkrimtar. Kisha mendimin se më duhej ta shkruaja romanin që duhej ta shkruaja për ta fituar të drejtën për ta quajtur veten shkrimtar. *Një Kokërr Gruri* (1967) dhe *Petale Gjaku* (1975) ishin përpjekje drejt atij qëllimi. Por, në kohën që i përfundova këto dy

vepra, qëndrimi im ndaj anglishtes si gjuha parësore e krijimtarisë sime, kishte ndryshuar; përqafova gjuhën time Gikũyũ. Përpjekjet, për ta shkruar atë roman që jam përpjekur, por që akoma nuk kam arritur ta shkruaj, i vazhdoj edhe në gjuhën Gikũyũ. *Djalli mbi Kryq* (1980) dhe *Magjistari i Sorrës* (2006), janë rezultat i angazhimit tim të ri. Tani, kam arritur ta kuptoj se, shkrimi nuk ka moment mbërritje – ose më mirë, momenti i mbërritjes është fillimi i një faze të re të udhëtimit. Ai përbën një sfidë të vazhdueshme.

Drama juaj e hershme *Plagosja në Zemër* nuk u lejua të botohet, sepse në të përmendet një oficer britanik që përdhunon gruan e një ushtari të LFU-së. Ju e patët të vështirë ta pranoni këtë akt të censurimit politik, siç edhe dëshmohet në kujtimet e tua te, *Lindja e Endësit të Ëndrrës: Zgjimi i një Shkrimtari* (2016).

Ishte ajo gënjeshtra e madhe e cila paraqitej si arsyeja që nuk e lejonte dramën të luhej në Teatrin Kombëtar, dhe që më bëri të ndalem një çast e të mendoj për mizoritë e kryera nga pushteti kolonial britanik kundër kenianëve. Një nga gënjeshtrat e çdo shteti kolonizator ishte se sundimi i tyre ishte më i butë dhe më dashamirës sesa ai i fuqive të tjera koloniale rivale. Logjika ishte e tillë: politika e tyre është më e keqe se e jona, ndaj, politika jonë është më e mirë; më e mira është një shkallë më lart se e mira, për pasojë, e jona është e mirë. Ai ishte një moment i rëndësishëm në jetën time, sepse, në një mënyrë të çuditshme, më nxit të shkruaj. Kjo është arsyeja që kujtimet fillojnë me ndodhinë. Tani që hedh vështrimin prapa në kohë, kuptoj se ai moment parafytyroi atë që do të ndodhte vite më vonë, dhe të gjitha për shkak të teatrit, si mbajtja ime në një burg të sigurisë së lartë në Kenya në periudhën 1977 - '78.

Një pjesë e madhe e suksesit tuaj është arritur jashtë Kenya-s, ngaqë ju keni qenë i larguar në mërgim për më se tre dhjetëvjeçarë. A largohet ndonjëherë vetëdija e jetësismit që buron nga ai realitet?

Jo, jo shumë, por unë jam përpjekur ta përballojë atë me dijeninë se mërgimi ka ndikuar mbi historinë në mënyra të çuditshme dhe magjepsëse. Ja, mendoni Moses-in dhe Jesus-in në Egjipt, Muhammad-in dhe ndjekësit e tij që gjetën strehim në Etiopinë e krishterë, Marx-i dhe Engels-i në Francë dhe në London. Përvoja e mërgimit krijoi kushtet për një mugullim të mendimit, i cili më vonë, pati ndikim në vendlindje. Besoj se këtë kishte ndërmend shkrimtari me origjinë nga Afrika dhe Karaibet, George Lamming, me titullin e tij të famshëm, *Kënaqësitë e Mërgimit* (1960). Në

librin tim *Globalectics: Teoria dhe Politika e të Diturit* zhvillova një botëkuptim të cilin e quaj 'imagjinatë globalektike.' Ai është një zgjerim i vizionit të Blake-ut, i cili e shikonte botën në një grimcë rëre, ndërsa përjetësinë, në harkun kohor të një ore. Ne jemi të ndërlidhur.

A ka përbërë të qenit fizikisht larg nga Kenya një problem për ju, apo e gjitha ajo për të cilën keni nevojë të shkruani vazhdon të jetojë në kujtimet tuaja? Cilat janë disa nga vështirësitë e veçanta që keni provuar tek shkruani nga larg?

Kenya është gjithmonë në mendjen time. Më mungon e përditshmja e jetës keniane. Gikũyũ flitet kryesisht në Kenya. Ajo është njëra prej gjuhëve të tjera afrikane. Një mozaik gjuhësh, ajo është Kenya. Tani, unë shkruaj kryesisht në Gikũyũ, ndaj dhe do të dëshiroja të isha pjesë e peizazhit gjuhësor të ndryshimeve të saj.

Doja të pyesja nëse jeni shqetësuar ndonjëherë se nuk do të keni lexues të mjaftueshëm për faktin se ju shkruani për një komb dhe një moment historik, për të cilët, njerëzit pak dëgjojnë e lexojnë sot. A ka qenë karakteri i gjithësishtëm ndonjëherë shqetësim për ju?

Unë besoj se karakteri i gjithësishtëm është fëmija e veçorisë. A e mban mend atë grimcën e rërës? Ajo përmban botën. Shkrimtari duhet t'i qëndrojë besnik asaj grimce që të jetë në gjendje ta përfytyrojë gjithësinë.

A mendoni se auditori perëndimor mund t'i kuptojë plotësisht librat tuaja? A ka pjesë në shkrimet tuaja, të cilat, ju e ndjeni se mund të kuptohen vetëm nga disa audiencia – veçanërisht kenianët?

Nuk mendoj se ekziston veprë që mund të kuptohet vetëm nga një bashkësi e veçantë. Ose, nëse ka, aty nuk ka art me vlerë. Gjithsesi, çdo lexues sjell në një veprë arti pikëpamjen e vet për botën, pikëpamje kjo e ravijëzuar nga përvojat e historisë. Për shembull, kritikët me përvojë koloniale mund të dallojnë boshllëqe dhe madje heshtje në vepra që vijnë nga qendra perandorake.

Më 1977, mbas vënies në skenë të dramës suaj të diskutueshme *Do të Martohem Kur të Dua*, ju u arrestuat dhe u burgosët pa gjyq për një vit. Në fakt, ju u burgosët për përdorimin e arteve skenike dhe të gjuhës suaj kombëtare për ta fuqizuar popullin tuaj. Gjatë kësaj kohe, ju morët parasysh ndërlidhimet e shkrimit në anglisht, dhe ishte pikërisht atëherë kur morët vendimin për të shkruar në gjuhën tuaj amtare Gikũyũ. Në një mënyrë të përsosur, ju shkruat *Djalli mbi Kryq* mbi letër tualetit në burgun e sigurisë së lartë Kamiti. Që nga ajo kohë, ju keni qenë në ballë të përpjekjeve për t'i nxitur shkrimtarët afrikane që ta përdorin gjuhën e tyre amtare. Si po shkon kjo betejë dhe si ndjeheni ju kur hidhni shikimin pas në fillimet e udhëtimit tuaj në gjuhën Gikũyũ?

Lufta vazhdon. Ne kemi nevojë për trininë shtet, botues, dhe shkrimtar që krijon hapësirën e duhur për gjuhët afrikane. Deri tani, shteti nuk është bërë i gjallë. Politika e tij i është përshtatur lastimit të gjuhëve evropiane paralelisht me varfërimin e gjuhëve afrikane. Hera herës, shteti post-kolonial shfaq një armiqësi aktive ndaj gjuhëve afrikane.

Kur ju u kthyet në Kenya, vetë ju dhe bashkëshortja juaj, u sulmuat brutalisht. A e lëkundit kjo besimin tuaj te vendi dhe bashkatdhetarët tuaj? Besoni se mund të ktheheni për gjithmonë dhe a do ta donit këtë?

Ishte pjesë e një modeli. Më 1977, siç e kemi diskutuar, më mbanin në një burg të sigurisë së lartë menjëherë pas ndalimit të dramës së parë moderne në gjuhën Gikũyũ (e cila u shkrua së bashku me Ngũgĩ Wa Mĩĩĩĩ dhe u interpretua nga fshatarë e punëtorë nga Kamĩĩĩĩĩĩĩ). Në vitin 1982, dy javë para daljes së romanit *Djalli mbi Kryq* në gjuhën Gikũyũ, botuesi im kenian, Henry Chakava, u sulmua përpara shtëpisë së tij në Nairobi. Një nga gsishtat që ia prenë me machete u desh t'ia riqepnin. Sulmi erdhi pas kërcënimeve që bëheshin nëpërmjet telefonatave anonime dhe që vazhduan për disa javë. Më 1987, diktatori Moi dha urdhër për arrestimin e personazhit kryesor të romanit tim të dytë në gjuhën Gikũyũ, *Matigari*. Më 2003, njëmbëdhjetë ditë para botimit të romanit të tretë në Gikũyũ, *Magjistari i Sorrës*, njerëz të armatosur sulmuan bashkshorten time dhe mua. Por, Kenya është vetë populli. Dhe populli kenian mua më mbështet. Kështu që unë kthehem dhe rikthehem dhe shkruaj e rishkruaj për Kenyan dhe popullin e saj të madh. Duke i folur popullit kenian, unë i flas botës.

Pavarësisht nga këto, ju nuk e humbët entuziazmin dhe vazhduat të shkruani. Përse dhe si?

Zotëroj vitalitetin për të shkruar. Shkrimtarët janë me të vërtetë pjesë e një tradite profetike. Në poemën e tij *Duke Gjuajtur Fjalë me Babain Tim*, djali im, Mũkoma wa Ngũgĩ, shkrimtar dhe profesor i anglishtes në Cornell, ka futur aty një personazh që thotë se të gjuash me fjalë është shumë e rrezikshme. Shikoni pak të gjithë profetët që janë burgosur, dëbuar ose thjesht ekzekutuar. Ajo çka ata zotëronin ishte fjala. Unë shkruaj sepse jetoj.

Në *Lindja e Endësit të Ëndrrës*, ju i jeni referuar trashëgimisë dhe kujtimeve tuaja historike duke shkruar: 'Imazhet e mizorive të shumta, të kryera nga regjimi i kolonëve të bardhë në Kenya, konkurojnë me mua.' Dhe, siç e thatë, ju keni qenë viktimë e tentativave për vrasje, burgim, persekutim, dhe futje në lista të zeza. Kujtimi i gjithë dhunës që keni parë dhe provuar, mos ndoshta e ndryshon mënyrën sesi shkruani?

Kujtimet e dhunës koloniale akoma më faniten. Po kështu ndodh edhe me dhunën e ushtruar ndaj familjes sime. Kur shikoj masakrat në Lindjen e Mesme ose dhunën e pakuptimtë të policisë ndaj afro-amerikanëve rrugëve të Shteteve të Bashkuara, ato imazhe më rikthehen. Në raste të tilla, punoj më shumë. Dua ta shoh botën pa burgje dhe kampe përqendrimi, pa të pastrehë dhe të uritur. Dua t'i shoh fundin logjikës që qëndron pas zhvillimit modern, sipas

së cilit, që të ekzistojë dikush, duhet të zhduken të tjerë, si edhe mendimit që, për të pasur njëmijë milionerë ose miliarderë, duhet të ketë një miliard të varfër. Na duhet t’i japim fund marrëzisë së mendimit se numri i miliarderëve që ka një vend, tregon edhe shkallën e zhvillimit të tij. Çfarë mund të themi për miliarda të varfër që krijohen nga miliarderët?

A ka ndonjë gjë për të cilën nuk shkruani dot sepse ajo është tepër e dhimbshme?

Ne shkruajmë për dhimbjen për të ndihmuar që ta përballojmë atë – që me shpresë t’i japim fund asaj. Ne duam t’i ndihmojmë njerëzit që ata të luftojnë për shërimin e plagëve njerëzore. Brecht-i dikur u shpreh: ‘Në kohë të trishtueshme / A do të ketë dhe këngë? / Po, këngë do të ketë / Për kohët e trishtueshme.’ Kjo poemë është edhe epigrafi i librit im, Ëndrra në Kohë Luftë (2010).

Çfarë konsideroni si arritjen tuaj më të madhe të karrierës deri tani?

Për mua, tekste të ndryshëm kanë kujtime të ndryshme. Për këtë arsye, janë të gjitha, në mënyrë të barabartë, të preferuarat e mija. Nëse zgjedh, *Djalli mbi Kryq*, është për shkak të rrethanave të pazakonta në të cilat ai u shkrua. Ai ishte gjithashtu romani im i parë në Gikūyū, gjë që e bën atë romanin e parë në këtë gjuhë. Jam i kënaqur edhe nga një roman tjetër i imi në gjuhën Gikūyū, i shkruar gjatë viteve të mërgimit, *Magjistari i Sorrës*, i cili në vitin 2006 fitoi çmimin California Gold Medal, dikur i fituar nga John Steinbeck. Them gjithmonë me shaka se *Magjistari i Sorrës* është romani i vetëm në botë i shkruar midis dy portokalleve. Këtë e them sepse romanin fillova ta shkruaj në Orange (portokall), New Jersey, dhe e përfundova në Orange County, California.

Si e vlerësoni suksesin e secilit libër që keni shkruar?

Është e vështirë. Unë provoj një gëzim të veçantë kur një lexues, kudo në botë, më thotë se një pasazh i posaçëm ka ndikuar në jetën e tij ose të saj. Një aktivist politik indian, të cilin rastisa ta takoj njëherë në Hyderabad, më falënderoi për *Djalli mbi Kryq*. Kishte planifikuar të kryente vetëvrasje, por i rastisi të futej në një librari, bleu librin tim, e lexoi; libri i dha atij mundësinë që të gjente një qëllim të ri në jetë. Në momente të tilla, përlothem dhe e kuptoj se, e gjithë përpjekja e investuar në krijimin e veprës, ia ka vlerë. Lumturohem kur lexuesit më thonë se *Magjistari i Sorrës* i bën të venë buzën në gaz. Gjatë një pritje që u organizua njëherë në Duke University, takova dy profesorë, zgjedhja e karrierës së të cilëve – njëra në drejtësi dhe tjetra në letërsi – ishte ndikuar nga takimi i tyre me avokatin progresiv, personazhin e romanit *Petale Gjaku*. Profesori i letërsisë, në fillim interesohet për drejtësi, por kur pa se çfarë është në gjendje të bëjë një roman, ndërroi karrierë duke zgjedhur letërsinë, kurse profesori i drejtësisë kishte qenë i interesuar për letërsinë, por pas takimit me personazhin imagjinar, kaloi në drejtësi.

Nëse dikush nuk e njeh veprën tuaj, me cilat libra mendoni se duhet ta fillojë?

E pse të mos fillojë me Ëndrra në Kohë Luftë dhe *Mos Qaj, Fëmijë* (1964)? Ato burojnë nga e njëjta periudhë kohore e fëmijërisë sime, dhe do të ishte interesante ta shikonin sesi fikcioni dhe kujtimet e hedhura në libër ndryshojnë nga përjasjet që ato i bëjnë realitetit. Por, nëse doni të qeshni që të mos qani, mund të lexoni *Magjistari i Sorrës*. Përndryshe, secili prej romaneve të mija do t’ju çojë tek të tjerët.

A ka ndryshuar stili i prozës suaj dhe struktura e rrëfimit ndër vite?

Dy romanet e para, *Mos Qaj, Fëmijë* dhe *Lumi në Mes* (1965), karakterizohen nga struktura të rrëfimit linear dhe fjali të shkurtra. Më vonë, në romanet *Një kokërr Gruiri* dhe *Petale Gjaku* fillova të interesohem në shtresëzimin e kohës dhe hapësirës. Struktura lineare zëvendësohet nga linja të shumëfishta që përshkojnë kryq e tërthor, me rezultat krijimin e shumë personazheve, hapësira të panumërta, kohë të shumëfishta, dhe linja të pafund zhvillimi. Kishte nevojë për ndryshimin e fjalive nga të shkurtra në të gjata.

Ashtu si me progresionin e stileve tuaja, dikush mund ta ndjekë edhe evoluimin e ideve sociale dhe politike tek lexon librat tuaj sipas radhës.

Unë interesohem për veprimtarinë e pushtetit në shoqëri. Nuk ka aspekt të jetës që të mos ndikohet nga kush dhe cila klasë shoqërore mban pushtetin në shoqëri, si edhe synimet në funksion të të cilave është vendosur ai pushtet. Unë, me të vërtetë, kam evoluar. Por, kam qenë konsekuent në shikimin e botës nga pikëpamja dhe nevojat e më të paktëve mes nesh. *Globalectics* përmbledh afërsisht pikëpamjet e mija sot: jeta është e ndërlikuar – toka, uji, qielli, i gjithë krijimi, dhe gjithçka që bën të mundur dhe mban gjallë krijimin. Tani e kuptoj përse njerëzit në lashtësi adhuronin diellin, nderonin ujin, zjarrin, dheun, si edhe botën bimore e shtazore. Në Gikūyū-n parakolonial, ishe i detyruar të mbillje një fidan peme në vend të pemës që prisje apo shkulje me rrënjë. Toka është mëma jonë e përbashkët, dhe asnjë popull apo grup njerëzish nuk duhet të pretendojë se ajo i përket më shumë atyre se të tjerëve. Është kjo arsyeja që unë tani mendoj se abuzimet e mëdha ndaj ambientit janë krime kundër njerëzimit dhe jetës. Ndotja e ujit dhe e ajrit kudo, ndikon mbi vetë krijimin kudo.

Çfarë ju detyroi t’i ktheheni jetëshkrimit si formë të shkruari?

Jetëshkrimi më ndihmon ta shpjegoj veten. Atë e përdor për të thënë, ‘Ej, jam ende gjallë, dhe akoma besoj të gjuhët afrikane, dhe po, më duhet të luftoj me të gjitha mjetet letrare të mundshme.’ Nganjëherë marr shpërblime të papritura. Një fabul e shkruar në gjuhën Gikūyū tani është përkthyer në gjashtëdhjet e një gjuhë, dyzetë prej të cilave janë afrikane. Fabula titullohet *Revolucioni i Drejtë: Ose Përse Njerëzit Ecin Drejt*. Jam i entuziazmuar sepse



njerëzit që qëndrojnë prapa projektit janë një grup të rinjsh ndër-afrikanë të angazhuar me Projektin e Botimeve Jalada. Ata drejtohen nga Moses Kilolo, kryeredaktori i tyre.

Ju keni shkruar tre auto-biografi: Ëndrra në Kohë Luftë, Në Shtëpinë e Përkthyesit dhe Lindja e Endësit të Ëndrrës. A mendoni se do të shkruani edhe një tjetër, duke rifilluar aty ku e latë Endësin e Ëndrrës?

Të tre librat shkojnë deri në vitin 1964. Do të më pëlqente të bëja më shumë, por se pari, dua të shkruaj një roman tjetër. Romani më shpie në vende dhe botë të ndryshme, gjë që asnjë zhanër tjetër nuk ka mundur ta bëjë. Ironia është se teatri ka pasur një ndikim më të madh sesa romani në jetën time, përfshirë këtu edhe artin e fiksonit. Në fund të fundit ishte drama ajo që më dërgoi në Burgun Kamiti, ku edhe mendova sërisht për çështjen e gjuhës dhe nisa romanin tim të parë në gjuhën Gikūyū.

Shkrimet tuaja angazhojnë, si çështjet e mëdha që shqetësojnë shoqërinë, ashtu edhe çështje po aq kritike që i përkasin protagonistëve tuaj të veçantë. Çfarë ju preokupon më shumë kur filloni të punoni me një roman?

Kjo ndryshon nga romani në roman, por fillon kryesisht me një imazh, me një ide të mjegullt. Krijimtaria është si një eksplorim i së panjohurës. Shpesh, befasohem nga personazhe që shfaqen papritur dhe që madje ngrënë edhe çështje që nuk i kisha menduar. Kjo është arsyeja që romani i radhës ndryshon gjithmonë nga ai që e paraprin. Por, ato janë rrëfime të të njëjtit eksplorator të shoqëruara nga tekat e tij të veçanta. Lulja, tek e cila ndalem për ta shikuar, mund të jetë e ndryshme nga ajo që magjeps një tjetër eksplorator.

A ka tema apo subjekte për të cilat keni dashur të shkruani, por që nuk keni arritur t’i realizoni?

Jo aq shumë tema sesa sfida e një romani të ri. E kuptoni, romani im më i mirë është ai që akoma më duhet ta shkruaj.

Interesante! A ka dorëshkrime të pabotuara në sirtarët e tavolinës suaj të punës?

Po, disa; ndoshta mund të jenë shtatë, të gjitha së bashku. Ato janë të tëra në gjuhën Gikūyū, përfshirë këtu, edhe tre përkthime nga Molière dhe Gogol.

Në romanin Djalli mbi Kryq, ju shkruani, Jeta jonë është një fushëbetejë në të cilën zhvillohet një luftë e vazhdueshme midis forcave të zotuara për ta konfirmuar humanitetin tonë dhe atyre që janë të vendosur për ta shpërbërë atë; atyre që mundohen të ndërtojnë një mur mbrojtës rreth tij dhe të tjerëve që duan ta shembin atë; ata që kanë për qëllim të na hapin sytë, të na japin mundësinë ta shikojmë dritën dhe ta vështrojmë të nesërmen [...] dhe ata që dëshirojnë të na nanurisin dhe të na mbyllin sytë.

Kjo i përshtatet shumë sot Shteteve të bashkuara, vendit tuaj të zgjedhur. Cili mendoni se është roli i artistit, akademikut, dhe intelektualit në klimën e politikës së sotme amerikane?

Besoj se ishte Ousmane Sembene, autori dhe producenti senegalez, i cili foli për shkrimtarin si zëri i të pazëshmëve. Kjo vlen për të gjitha shoqëritë. Arti duhet t’i ndezë ëndrrat tona për një botë më humane.

E di se kjo është një pyetje tepër e gjerë, por çfarë shpresoni të arrini nëpërmjet shkrimit tuaj?

Fuqizimin e gjuhëve afrikane dhe të gjitha gjuhëve të tjera të nënvlehtësuara të botës. Unë jam bërë një luftëtar i gjuhës. Dhe e dua këtë – fshikulluese, po, por luftën e kam përqafuar.

Ju filluat të shkruani në gjuhën Gikūyū si një akt rezistence. Në dyzetë vitet e fundit, ju keni hapur rrugën për shkrimtarët afrikanë që dhe ata të bëjnë të njëjtën gjë. A ka ndryshuar peizazhi letrar mjaftueshëm?

Jo nëpërmjet shkrimeve dhe botimeve në gjuhët afrikane. Por, qëndrimet kanë ndryshuar. Kur botova për herë të parë librin *Dekolonizimi i Mendjes* më 1986, u përballa me shumë armiqësi, pësthirë, përqeshje, tallje. Këtë nuk e shoh më. Por, që të jem i ndershëm, gjithmonë ka pasur afrikanë që kanë shkruar në gjuhë afrikane. Në një konferencë të mbajtur në Asmara, Eritrea, më 2000, pjesëmarrësit ishin shkrimtarë të gjuhëve afrikane që erdhën aty nga të gjitha qoshet e Afrikës. Ata përpiluan një dokument të famshëm, një lloj manifesti për gjuhët afrikane, të quajtur Deklarata e Asmara-s.

Ka rreth gjashtë milion njerëz që flasin Gikūyū në Kenya, në një kohë që librat tuaj në gjuhën Gikūyū kanë korrur të njëjtin sukses si edhe librat e shkruar në gjuhën angleze. A ju jep kjo një ndjesi përligjje?

Ishte një befasim i këndshëm edhe për mua. Nuk jam i sigurt nëse librat në Gikūyū kanë mundur ta ruajnë atë nivel interesi. Shkolla dhe i gjithë sistemi arsimor nuk i mbështet gjuhët afrikane. Për shembull, tekstet e mija në gjuhë angleze kanë shumë të ngjarë të përdoren në shkolla dhe kolegje, kështu që ato nuk varen plotësisht nga lexuesi i përgjithshëm. Librat në gjuhën Gikūyū nuk bëjnë pjesë në programet e shkollave dhe të kolegjeve.

A mendoni se shkrimtarët duhet të shkruajnë në gjuhën e tyre amtare dhe pastaj t’i përkthejnë ato në anglisht?

Së pari, shkrimtarët nuk duhet të ndjehen të detyruar t’i përkthejnë veprat e tyre në anglisht. Unë e bëj këtë sepse nuk jam dakord me ata që thonë se të shkruash në një gjuhë afrikane i mohon afrikanëve dhe popujve të tjerë të drejtën për t’i lexuar këto vepra. Më dëgjoni, kjo nuk thuhet për shkrimtarët që shkruajnë në gjuhët evropiane, veprat e të cilëve janë të përkthyer më gjerë. Problemi është se, për fat të keq, ata që shkruajnë në gjuhë afrikane mbeten të padukshëm, punimet e tyre recensohen dhe përkthehen me vështirësi. Vendet ku mund të betosh janë të kufizuara. Sigurisht, pavarësisht nga pengesat, vepra ka, për shembull, në Kiswahili. Kiswahili është një nga gjuhët afrikane që flitet në Afrikën Lindore dhe Qendrore. Ajo ka një traditë të madhe letrare e cila ka nxjerrë dhe vazhdon të nxjerrë krijime fantastike nga autorë si, Shaaban Robert dhe Abdilatif Abdalla.

Ju keni thënë se përkthimi është një mënyrë për t’i dhënë ndihmesë komunikimit ndërkulturor. Kjo është arsyeja që ju i përktheni vetë librat tuaj në anglisht. Disa persona argumentojnë se kjo e kundërshton deklaratën që ju keni bërë në lidhje me të shkruarit në Gikūyū.

Përkthimin e kam përshkruar si gjuha e përbashkët e gjuhëve. Ndaj unë nuk jam kundër anglishtes ose ndonjë gjuhe tjetër. Ajo që unë kundërshtoj plotësisht është lidhja e pabarabartë e pushtetit midis tyre. Anglishtja nuk është më shumë gjuhë se çdo gjuhë tjetër. Kjo vlen për të gjitha gjuhët, të mëdha e të vogla. Kam qenë gjithmonë në favor të asaj që veprat e një gjuhe të jenë në dispozicion edhe të gjuhëve të tjera. Do të më pëlqente ta shikoja

letërsinë evropiane, aziatike dhe latino-amerikane të përkthyer në gjuhët afrikane dhe anasjelltas. Disa nga veprat e mija janë përkthyer nga Wangüi wa Goro në anglisht. Të tjera vepra janë përkthyer në gjermanisht, suedisht dhe japonisht nga persona të tjerë.

Në Dekolonizimi i Mendjes, ju jeni shprehur, ‘Gjuha është një mjet i nënshtimit shpirtëror.’ Ju gjithashtu keni thënë, ‘Kolonializmi normalizon anormalen,’ tek flisni për gjuhën e kolonizatorit që bëhet gjuha e rendimentit intelektual në vendin e kolonizuar. Gjithashtu, ju e keni quajtur përkthimin një akt politik. Mund ta shpjegoni këtë?

Procesi normal i njohjes është të fillosh nga aty ku ndodhesh, nga ajo që ke përvetësuar dhe pastaj ta shtosh dijen. Në rastin e gjuhëve, kjo është e thjeshtë. Zotëroje gjuhën tënde, shtoji asaj gjuhë të tjera: rezultati është rritje përgjegjësie.

Keni pohuar në mënyrë të përsëritur se ‘anglishtja nuk është gjuhë afrikane’ dhe keni shprehur zhgënjimin tuaj për faktin se çmimet letrare për shkrimtarët afrikanë iu jepen atyre që shkruajnë në anglisht.

Nëse britanikët do të shkruanin në japonisht, a e bën kjo japonishten gjuhë angleze? Zemërohem kur ajo që shkon deri në vjedhje të identitetit letrar, ku letërsia që shkruhet nga afrikanët në gjuhë evropiane merr identitetin e letërsisë afrikane. Atëherë, çfarë mund t’i quajmë shkrimet afrikane në gjuhët afrikane?

Nga njëra anë ka shumë autorë që mund të shkruajnë në gjuhët e tyre amtare dhe më pas t’i përkthejnë veprat e tyre në anglisht, nga ana tjetër, ka një mangësi përkthimesh nga anglishtja në gjuhët afrikane. ‘Ajo çka përkthehet nga anglishtja dhe në anglisht – dhe në çfarë sasië – është çështje pushteti,’ keni thënë ju. Kush mendoni se ka më shumë të ngjarë ta bëjë këtë punë të qenësishme?

Mendoj se e njëjta trini e shtetit, botuesit dhe përkthyesit mund të siguronte një transferim masiv të dijes nga gjuhë të tjera drejt gjuhëve afrikane. Tani, kemi edhe çmimin Mabati-Cornell Kiswahili për letërsinë afrikane. Im bir, Mukoma wa Ngūgi, ishte ndërmjet themeluesve të çmimit, dhe tashmë, në tre vitet e ekzistencës së tij, ai, çmimi, ka prodhuar një sasi të konsiderueshme fiksioni dhe poezie në gjuhën Kiswahili.

Ju keni qenë një mbështetës i transformimit rrënjësor të shoqërisë në Afrikën post-koloniale. A po e shikoni ndryshimin që prisnit ta shihni apo jeni i zhgënjyer me gjendjen ku ndodhet Afrika sot?

Unë jam krenar për atë që Afrika dhe popujt afrikanë kanë arritur pavarësisht nga vite të tëra të një skllavërie fizike, koloniale, dhe sot, financiare. Afrika po ngrihet edhe pse ka një këmbë e një dorë të lidhur në Perëndim. Për fat të keq, Afrika akoma drejtohet nga e njëjta logjikë e zhvillimit kapitalist, e cila thotë se mirëqenia e pakicës tregon nivelin e përparimit. Ne, ende, kemi nevojë për një transformim të shoqërisë, por hapi i parë duhet të jetë lufta që Afrika t’i sigurojë rezervat natyrore të kontinentit. Afrika ka qenë gjithnjë dhurata që vazhdon t’i jepet perëndimit. Ka ardhur koha që Afrika t’i sigurojë burimet e veta, të krijojë me ato, dhe pastaj të vendoste një lidhje të balancuar shkëmbimesh me pjesën tjetër të botës. Jam përpjekur ta paraqes këtë argument në librin: Siguro Bazën: Krijimi i Afrikës së Dukshme në Botë (2016).

Ju besoni në atë që kombet duhet të mbajnë përgjegjësi për atë që kanë bërë, dhe për atë që udhëheqësit e tyre kanë bërë. Ju keni folur për përgjegjësinë britanike ndaj kombeve të kolonizuara, për sflitjen dhe dhimbjen që i shkaktuan popullsisë vendase gjatë pushtimit. A keni shpresë se një ditë njëfarë ngushëllimi, edhe pse i vonshëm dhe i pamjaftueshëm, mund të ofrohet?

Perëndimi vazhdon të refuzojë ta marrë përgjegjësinë për mizoritë kundër popujve të kolonizuar. Madje edhe sot, Shtetet e Bashkuara akoma refuzojnë të kërkojnë të falur për skllavërimin e miliona njerëzve. Në *Siguroi Bazën*, unë vë në dukje se tre shtete me një sasi të madhe armësh të dëmtimit masiv – domethënë, Shtetet e Bashkuara, Britania dhe Franca – ishin disa prej shteteve kryesore të tregtisë së skllëvërve dhe zotërimit të tyre. E katërta, Rusia, kishte skllëvërit e saj të brendshëm, Shpirtrat e Vdekur të Gogol-it.

Ju vini nga një familje tregimtarësh që u rritët me traditën e pasur gojore të Kenyas. Në të njëjtën kohë, juve nuk ju lejohej të flisnit në gjuhën Gikūyū, gjuha juaj amtare; në sistemin shkollor kolonial, dhe deri në vitet e universitetit ishit i detyruar të lexonit letërsi evropiane dhe amerikane në kurriz të veprave keniane dhe afrikane. Në kujtimet tuaja, ju flisni për dyfaqësinë e asaj përvoje: ‘Të lindesh e të shkollohesh në një koloni, në mënyrë të paevitueshme, lë shenja të përhershme.’ Akoma nuk jam i qartë nëse ndjeheni se zhvillimi juaj si shkrimtar dhe kritik do të kishte qenë i njëjti në qoftë se nuk do ju ishte dashur të luftonit për të drejtën dhe njohjen e gjuhës suaj, historisë, dhe kulturës.

Çdo shkrimtar formohet nga rrethanat e edukimit, përvoja e përgjithshme e jetës, betejat e veta. Trashëgimia gojore më çoi në letërsi. Siç e tregoj të Ëndrra në Kohë Luftë, kur ishim fëmijë na thuhej se gojëdhënat fshiheshin gjatë ditës dhe ktheheshin në mbrëmje kur të gjitha punët e ditës kishin përfunduar. Kjo mund të ketë qenë një dredhi e familjes sonë që të na detyronte t’i bënim punët, dhe në mbrëmje të na shpërblenin me rrëfime, por unë, ama, i besoja ato që na thuheshin. Sidoqoftë, unë digjesha nga dëshira për të dëgjuar gojëdhëna edhe gjatë ditës. Kur mësova të lexoj mu dha mundësia t’i rrëfeja vetes histori të ndryshme në çdo moment të ditës. Për fat të mirë, atëherë, katër vitet e para të shkollës i kryem në gjuhën Gikūyū, dhe kështu ndodhi që libri i parë që lexova në atë gjuhë ishte Testamenti i Vjetër. Përveç biblës, titujt e librave në Gikūyū kufizoheshin në disa libra shkollorë. Ishte

anglishtja ajo që hapi botën e pafund të librave tek unë. Më lejoni që ta bëj të qartë se ishin autorët anglezë ata që shijoja së lexuari: Shakespeare, Jane Austen, George Eliot, Dickens, Joseph Conrad, D. H. Lawrence, E. M. Forster, et cetera. Shijoja gjithashtu letërsinë ruse të përkthyer në anglisht: Dostoyevsky, Chekhov, Turgenev, Tolstoy, Gorky, and Sholokov. Ndërmjet shkrimtarëve francezë, Balzac-u ishte i mrekullueshëm. Më vonë, zbulova letërsinë e Karaibeve: George Lamming, V. S. Naipaul, Roger Mais, Kamau Brathwaite, dhe, sigurisht, shkrimtarët afro-amerikanë: Langston Hughes, Claude McKay, Richard Right, James Baldwin, Amiri Baraka, Sonia Sanchez. Shkrimtarët afrikanë, direkt nga anglishtja, dhe të pëkthyer në anglisht ishin një tjetër zbulim: Peter Abrahams, Es’kia Mphahlele, Alex La Guma, e të tjerë.

Të gjithë këta autorë vinin tek unë nëpërmjet anglishtes. Ajo që mungonte në këtë peizazh letrar ishte letërsia në gjuhët afrikane, përfshirë edhe gjuhën time Gikūyū. Qarkullonte diçka në Kiswahili, por gjithsesi, pjesa më e madhe e letërsisë ishte në gjuhën angleze. Në kohë që fillova të shkruaj, ashtu si shumë shkrimtarë të brezit tim, e mora si të vërtetë se anglishtja ishte gjuha e natyrshme për shprehësinë tonë letrare. Më vonë, arrita të vë në dyshim supozimin e përgjithshëm dhe të gjithë mungesën e ekuilibrit të pushtetit midis gjuhëve afrikane dhe evropiane. Vura në dyshim shkollimin kolonial që i bënte gjuhët afrikane të padukshme përballë anglishtes dhe gjuhëve evropiane. Lufta për gjuhën solli burgun dhe mërgimin, por jam shumë krenar për faktin se ajo luftë më ndihmoi të guxoj të shkruaj në gjuhën Gikūyū.

Shumë afrikanë kanë pasur të njëjtën eksperiencë me ju: atyre iu rrëmbye gjuha amtare dhe gjuha e kolonizatorit iu imponua nëpërmjet edukimit shkollor. Ju keni mbështetur idenë e mësimdhënies në një gjuhë afrikane në rolin e gjuhës së dytë.

E drejta e gjuhës është një e drejtë njerëzore, dhe jo një privilegj. Çdo popull ka të drejtën e gjuhës së vet, dhe për pasojë, të drejtën e krijimit intelektual në atë gjuhë. Të kesh më shumë se gjuha amtare, është një privilegj i madh. Ishte Aimé Césaire nga Martinika, i cili, në librin e tij *Ligjëratë mbi Kolonializmin* (1950), e përshkruan kontaktin kulturor si oksigjenin e qytetërimit. Por ai nuk është kontakti kulturor i kalorësit me kalin. Besoj se e njëjta gjë vlen edhe për gjuhët: kontakti gjuhësor mund ta krijojë oksigjenin e humanitetit tonë të përbashkët, por vetëm kur gjuhët lidhen në një rrjet barazie dhe jo në një hierarki pushteti. Është e vërtetë se qeveritë post-koloniale vazhduan politikat e mënjanimit të gjuhëve afrikane tek lartësonin gjuhët evropiane. Procesi normal i njohjes ka të bëjë me shtimin e dijeve që ke dhe jo me çrrënjosjen e atyre që zotëron dhe rivendosjen e tyre sërish në një grup tjetër mjtesh gjuhësore në funksion të dijeve. Sikur t’i dinit të gjitha gjuhët e botës, por mos ta dinit gjuhën amtare ose gjuhën e kulturës suaj, do të ishit i skllavëruar. Kur zotëron gjuhën amtare dhe gjuhën e kulturës tënde, duke iu shtuar atyre të gjitha gjuhët e botës, i fuqizohesh. Zotërimi i një gjuhe të vetme është gazi karbonik i qytetërimit. Natyrisht, ka bashkësi, e drejta e gjuhës së të cilës u mor – nëpërmjet forcës së ligjit dhe të dhunës. Por, ato krijuan gjuhë të reja. Ato gjuhë kanë të drejtën e vet të ekzistojnë, dhe si gjuhët afrikane, nuk janë një rang më poshtë shkallës së providencës angleze.

Botimi juaj i parë ishte te *Penpoint*, një revistë letrare e degës së anglishtes në kolegjin tuaj. Në fillim të viteve nëntëdhjetë, ju nisët gazetën *Mũitiiri* në gjuhën Gikūyū. A mund të flisni për rolin e revistës letrare në udhëtimin e një shkrimtari?

Unë besoj shumë te revistat, sidomos te ato për studentët. Ato ma dhanë rastin. Si në të gjitha kulturat, revistat vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në nxitjen për krijimtari në gjuhët afrikane. Më lejoni t’i përmend disa: *Penpoint* në Makerere; *The Horn* në Ibadan. Dhe disa të tjera, *Transition*, *Kwani*, *African Literature Today*, *Black Orpheus*, e të tjera. *Mũitiiri* ka siguruar një platformë për shumë shkrimtarë të gjuhës Gikūyū.

Duket se ende nuk ka shumë libra në gjuhët afrikane, ndaj njerëzit janë mësuar të lexojnë në gjuhët evropiane, ndërsa botuesit nuk duan të rrezikojnë me shkrimtarë që shkruajnë në gjuhën e tyre amtare. Ky duket si një rreth vicioz.

Të botosh është një nga sfidat më të pakëndshme kur shkruan në gjuhët afrikane. Zor se gjen shtëpi botuese që t’i përkushtohen këtyre gjuhëve. Prandaj, shkrimtarë të tillë nuk kanë asnjë farë shansi: shtëpi botuese nuk ka, mbështetja shtetërore mungon, dhe për më tepër, forcat kombëtare dhe ndërkombëtare rreshtohen kundër tyre. Çmime për përkrahjen e letërsisë afrikane jepen, por vetëm me kushtin që shkrimtarët të mos shkruajnë në gjuhë afrikane.



A mendoni se vet-botimi ose tregu dixhital mund të jenë zgjidhja?

Vet-botimi është një forcë e madhe në botë në ditët e sotme. Unë e quaj atë caku i ri i tejmë, brendësia e pa eksploruar e një vendi. Interneti e bën të mundur këtë lloj publikimi online. Interneti ka demokratizuar hapësirën e botimit. Gjithashtu, këtë bën edhe You Tube në një fushë jetike të shprehjes gojore dhe pamore.

A po ndjek leximi atë drejtim, sipas jush?

Teknologjitë e reja dhe mediat elektronike hapin mundësi shumë të gjëra. Te *Globalectics*, kam argumentuar se komunikimi gojor po rikthehet. Unë e quaj atë *cyberorality* – komunikimi gojor nëpërmjet internetit. I hidhni një vështrim gjuhës së internetit: dhoma bisedimi, miq të Facebook-ut, bashkësi, e të tjera. Mediat janë versioni elektronik i shëmbëllimit të mullirit të thashethemes së vjetër. Por, për Afrikën, caku i saj i tejmë është shkrimi dhe botimi në gjuhët e saj.

Mendoni se shkrimtarët më të rinj kenianë kanë dijeni të mjaftueshme për pasojat e trashëgimisë koloniale në gjuhën e tyre?

Pa ndryshim rrënjësor në shoqërinë tonë, shpallja e pavarësisë, si hap i rëndësishëm që ishte, shpesh nënkuptonte normalizimin e anomalive të sistemit kolonial. Për shembull, ushtritë koloniale që dikur luftonin kundër forcave të nacionalizmit antikolonial u shndërruan në ushtri kombëtare dhe forca policore. Normalizimi i anomalive të sistemit kolonial përbën një kërcënim të vërtetë për stabilitetin dhe lulëzimin e Afrikës. Si shembull mund të japim kontrollin e vazhdueshëm të ekonomisë nga korporatat perëndimore, dhe hendekun e madh midis atyre që janë të kamur dhe të varfërve. Piramida racore që vendoste të bardhët në majë, aziatikët në mes, dhe afrikanët në bazë, u kthye në një piramidë shoqërore, me pakicën në majë, një klasë të mesme, dhe shumicën në fund fare, në bazë. Të rinjtë, që dihet se nuk e provuan kolonializmin drejtpërsëdrejti, kanë si pikënisje anomalinë e normalizuar. Këto absurditete të epokës post-koloniale i detyrojnë të rinjtë që të ngrënë çështje të cilat i kthejnë ata te rrënjët koloniale të absurditeteve post-koloniale. Merrni për shembull Organizatën Ndër-afrikane Jalada. Të gjithë anëtarët e saj kanë lindur pas shpalljes së pavarësisë. Por, ata e kanë parë absurditetin e elitës afrikane që sjell ide në gjuhët evropiane, në një kontinent ku mbi nëntëdhjetë për qind e popullsisë flet gjuhë afrikane. Organizata Ndër-afrikane Jalada ka vendosur të bëjë diçka në lidhje me këtë. Ajo ka nisur një projekt përkthimi ndërmjet gjuhëve afrikane. Ajo është edhe forca që mbështet përkthimin e *Revolucioni i Drejtë* në gjashtëdhjetë gjuhë në Afrikë dhe në të gjithë botën.

Përveç korpusit tuaj, cilat janë disa nga librat e rëndësishëm që flasin për pasojat e kolonializmit, dhe që janë shkruar nga autorë afrikanë?

Pothuajse gjithçka afrikane që është botuar deri më sot. Madje edhe autorë ti rinj si Chimamanda Ngozi Adichie dhe Tsitsi Dangarembga kanë krijuar vepra që, në mënyrë brilante, shqyrtojnë imtësisht kolonializmin deri në post-kolonializëm. Peter Abrahams, Ousmane Sembene, Ferdinand Oyono, Mongo Beti, Chinua Achebe, Wole Soyinka, të gjithë këta shkrimtarë kanë krijuar vepra që, kolonializmin klasik, e shqyrtojnë imtësisht deri në bërthamën e tij.

Me cilat vepra mendoni se bisedojnë shkrimet tuaja?

Kohët e fundit shkrova një poemë në kopshtin e grua sime në Irvine, një lloj poeme lëvdatë, e titulluar *Kopshti Tjetër*. Është e shkruar në gjuhën Gikūyū, por është gjithashtu një poemë që bashkëbisedon me romancierin nga Samoa, Albert Wendt, i cili poemën e tij e shkroi në kopshtin e së shoqes në Zelandën e Re. Të dy patëm një shkëmbim poetik në një takim letrar në Hawai. Më pas, të dy poemat u botuan në një numër të veçantë të Hawai Review që i dedikohej ‘Thirje dhe Përgjigje.’ Poema ime mjaft e gjatë më shëtitu nga Irvine në Hawai, më pas në Kenya, dhe së fundi te historitë e indianëve të Amerikës. Më pëlqeu fakti që: një poemë në Gikūyū lidhi peizazhet dhe historitë e këtyre vendeve.

Ju keni lëvduar mamanë tuaj për ndikimin që ajo ka pasur në edukimin tuaj. Kur ishit fëmijë, ajo ju pyeste shpesh, ‘Ky është maksimumi yt?’ gjë që ju bëri të synonit për rezultate të shkëlqyera. Po, ju, ishit një prind i tillë? A është kjo arsyeja që fëmijët e tu Tee Ngūgi, Wajniku wa Ngūgi, Mukoma wa Ngūgi, dhe Nducu wa Ngūgi, ndoqën hapat e tua?

Jam shumë i gëzuar që ata po gjejnë zërin e tyre. Kurrë nuk i kam shtyrë të bëhen shkrimtarë. Lexues, po, por jo shkrimtarë. Kam dashur që ta japin maksimumin e tyre në çfarëdo zgjedhje që mund të bëjnë. Sidoqoftë, tani që ata janë shkrimtarë dhe me të drejtë kështu, ka qenë një kënaqësi e madhe që të bashkëpunojmë, siç kemi bërë në Jamaica, Florida, Los Angeles, dhe London. Por, e gjithë merita prindërore i shkon mamasë së tyre. Mua më është dashur të jem larg, në ndjekje të rasteve të rralla për shkollim; kam qenë në burg dhe në mërgim; kam bërë tentativë ndaj jetës. Ata i kanë vuajtur pasojat e aktivitetit tim letrar. Shtëpia ime në Kenya, shpesh bastisej, ndërsa familja merrej në pyetje sepse qarkullonin fjalë se unë isha kthyer nga mërgimi dhe se qëndroja i fshehur në shtëpi. Djemtë më tregojnë se për ata ishte shumë e tmerrshme kur shikonin imazhe të figurës-shëmbëlltyrë të babai të tyre që digjeshin dhe flakeshin në det me urdhrin e diktatorit të atëhershëm Moi. Mamaja e tyre, Nyambura, duhej ta mbante lart gjendjen shpirtërore. Ajo ka ndërruar jetë, por shpirti i saj, duhet të jetë duke i inkurajuar, dhe ashtu si edhe nëna ime, ndoshta po i pyet: ‘Ky është maksimumi juaj?’ Ata ndoshta do t’i thonin, ‘Kemi bërë ç’është e mundur, pavarësisht gjasave, por ne vazhdojmë të përpiqemi për më të mirën.’

**Nanda Dyssou është një gazetar dhe shkrimtar fiksioni me banim në Los Angeles.*

Përktheu: Aristidh Shqevi, Oslo, 28.10.2020

Kryq në
zemrën e saj
poezi nga
**ALEKSANDËR
BARDHI**

A E MBAN MËND ?!

A e mban mënd
E pabindura ime?

Të gjithë shkonin në
takim me Zotin
Ne merrnim me qera
shpellën e një ujku !....

SHPRESOJ TË MË NJOHËSH

Kur ti kalon
Ndizen dritat në qytet.
Unë e trëmbur fshihem
Pas kazanit të plehrave.

Ti se di kush jam unë
As kush kam qënë
As kush do të jem.

Se po ta dije
Të shtatë plumbat
Do t'mi derdhje në gojë
Për shpirtin tim të fundit.

Unë jam pronarja e parë
E zejeve të tua dinake !

Ti je dobia çliruese
E kënaqësive të mia
Të një kohe tjetër

Shpresoj të më njohësh
Mua – Penelopën e lavdive
të dikurshme
Që tani bëj jetën
E një maceje urbane.

APOKALIPTIKE

Në fillim kaluan zjarret,
Pastaj
vërsjuan ujrat.

Dhe urat u shëmbën
Dhe kështjellat ranë.

Mbeti vetëm një kasolle
me rrënjët në ujë
Dhe një thellëzë
e patruajtur
Që këndonte aty pranë.



Librat

poezi nga

HERMANN HESSE

Gjithë librat e kësaj bote
S'ta sjellin lumturinë
Por, fshehtas
të kthejnë tek vetja

Atje është gjithëka, për çfarë ke nevojë
Dielli, ylli dhe hëna
Sepse drita të cilën kërkon
Banon brenda teje

Dituria, që kaq gjatë e ke kërkuar
Nëpër librari,
Tani shkëlqen nga Çdo fletë -
Sepse tanimë ajo është e jotja

Përktheu nga origjinali: Silvana Semini

UNË I LUTEM HYJNISË TIME

Ra zjarr në tokë të thatë
Pa poetë, pa bilbila,
Një tufë zogjsh flakë e hollë
Japin shpirt nëpër kandila.

Unë i lutem hyjnisë time
Rri të lutem, rri dhe pak,
Në qiell yjet ndizen – fiken
Si flijime nëpër natë.

XHA AVRAMI NË TREGUN E DORDOLECËVE

Hajde xheneral, blini xheneral
Blini xheneral veshur me magji !

Dhe fronti do të çahet
Dhe shtegu do duket
Dhe rruga do hapet
Nga xheneralët e mi....

Hajde xheneral, xheneral zotri,
Në dhera pa Zot
I mblodha me qiri !....

AI

Kapelja që më hodhe
M'u bë çati mbi kokë.

Me brinjën e dhuruar
Ndërrova trarin e molitur.

Tani shkon e fle
Në fole të fatit tim.

GJURMA

Nuk është ajo
Hija e purpurt e thellëzës
Që u rrëzua
pa u vënë re
ndanë ujrave në muzg !
Është gjurma që la
në fytyrën tënde
Vdekja e ngadaltë e një ylli
që su pa.

DELJA E HESHTJES TIME

Është një strofull ujku
Nën një hënë gjaku
Si zilkë e shurdhuar.

Atje fle delja
e heshtjes time.

Se ujku nuk është më uj
Është dhe bariu i tufës memece
Që lind e vdes pa zë.

As bariu nuk është më bari
Është dhe zotnia im i ri
Që i bie me nge
Fytit tim të çarë !...

FËMIJËRI

Dikur, me shofer
Atje buzë Lanës
Dërgoja xixëllonja
Për qiellin e Tiranës.

Dhe përgjigje s'prisja
Për amanet – porosinë
Se drita e tyre vinte
Gjer në fshatin tim.

Unë se dija Tiranën
As rrugët s'ja dija
Po dhuratë dërgoja
Xixëllonjat e mia.

GAFORRET

Se ku shkojnë gaforret,
Se ku shkojnë
Në të kundërt të lumit;

I fundit kap bishtin
e të parit
I pari këput bishtin e të fundit.

Sadisti

tregim nga

ANDRIN

KABASHI

Të martën mbrëma, Olivia po shihte një ëndërr të keqe. Ishte në shtratin e saj dhe nuk ndihej mirë. Rrotullohej sa në të majtë e sa në të djathtë, por ishte e kotë. Ëndrra duket se ishte një nga ato makthet të cilat e kaplonin tash e një kohë të gjatë Olivian. Nuk u desh shumë dhe ajo u zgjua. Ishte djersitur e tëra. Mezi merrte frymë nga dihatja e rëndë.

Dhoma e saj ishte e errët. Ishte një dhomë tejet e zakonshme. Ishte e vogël dhe e ngushtë. Në pamje të parë të jepte mendimin si një dhomë e këndshme, por më vonë kuptoje se gjithmonë e më tepër ndiheshë i ngulfatur dhe disi i shtrënguar në gjoks. Bllokimi të zinte fytyrën si të të ngërthente një grusht i fortë, e që më pas vazhdonte poshtë, duke të të thyer brinjët për të të lënë pa frymë.

Olivia ishte një vajzë e re. Ajo gjithmonë qëndronte në shoqërinë e Amelia Johnsonit. Ishin mikesha të vjetra. Asgjë nuk fshihnin nga njëra – tjetra, madje as lidhjet e tyre me të dashurit e rinj. Gjithçka ishte transparente. Herë pas here ndodhte që ato të ziheshin, por fundja ishin mikesha të mira, ashtu të paktën dukeshin. Ato qenë rritur së bashku qysh të vogla, deri sot, në vitin e fundit të gjimnazit. Diçka e pazakontë kish zënë fill mes tyre. Kohëve të fundit marrëdhëniet e tyre nuk ishin edhe aq të mira sa kishin qenë. Vërehej qartazi se Amelia Johnsoni kalonte më shumë kohë në shoqërinë e re të Jessica Millerit. Dukej se shoqëria mes asaj dhe Olivia Harrisit, thjeshtë ishte harruar dhe nuk e di në mund ta quaj se ajo “ngjallej” nga vetëm një përshëndetje e thjeshtë. Kjo situatë po e dërrmonte tej mase Olivian. Ato ditë ishin të zymta për të. Gjithnjë e më tepër qëndronte e mbyllur në dhomën e saj të errët. Nuk donte që ndonjë t’i afrohej, mendonte se edhe ata do ta tradhtonin, njëlloj si qe tradhtuar më parë.

Ditët kalonin të zymta, të errëta dhe të thata. Fytyra e Olivias kish ndryshuar ngjyrë tash e një kohë të gjatë. Qëndronte e zverdhur gjithmonë. Buzët i kishte të purpurta dhe vende – vende me copëza trombi, nga gjaku që i rridhte prej buzëve të çara. Ishte sflitur e tëra. Tërë ditën qëndronte në dhomën e saj të errët e shtrirë mbi shtrat duke menduar gjëra nga më të ndryshmet, e duke u ndjerë gjithmonë keq e më keq. Dikush mund të thotë se kjo nuk është asgjë, se gjithmonë miqtë shkojnë e vinë, por jo Olivia, e cila qe tejet e lidhur me mikeshën e saj të fëmijërisë.

Dhoma ishte e qetë, nuk dëgjohej zë së gjalli; qetësinë e prishi vibrimi i celularit mobil të Olivias. Ishte një mesazh nga një i panjohur. Një nga këto mesazhet e aplikacioneve të dashurisë, apo siç njihen ndryshe “Online dating”. Fillimisht ajo vetëm mënjanoi celularin matanë, por ai gjithnjë e më tepër vazhdonte të vibronte. Kishin ardhur një seri mesazhesh dashurie nga një djalosh i quajtur Tom; Tomas Wilson. Në atë moment, Olivia u ngrit, dhe fytyra nisi t’i merrte tjetër trajtë. Filloi të buzëqeshte dhe u ndje mirë pasi që tashmë dikush qe interesuar për të dhe donte që të kalonte kohë së bashku.

Ajo ndjente dashuri, mirësi dhe kënaqësi nga mesazhet që Tomi i dërgonte çdo ditë. Kjo filloi të bëhej e përditshme dhe një kënaqësi e vazhdueshme. Është paksa e çuditshme se si të rinjtë sot flasin me të tjerët, me ditë të tëra pa u ndalur një çast, edhe pse kurrë në jetë nuk janë takuar fizikisht me personin në fjalë.

Kishte kaluar një javë e stër ngarkuar me biseda të ndryshme mes tyre, ku në krye të saj, Tomsoni i kish kërkuar Olivias të takoheshin në parkun e qytetit gjatë mesnatës. Natyrisht, Olivia kish pranuar pa një pa dy, dhe mezi e mbante veten nga emocionet që kishte për momentin e takimit.

Në këtë kohë të vitit mbrëmjet vinin shpejt. Ishte vetëm fillimi i Janarit. Gjithçka ishte gati. Olivia Harris kishte emocione. Do takonte për herë të parë djalin, i cili tash e një kohë i kishte rënë në kokë. Olivia Harris ishte e vetme në park. Edhe pak sa nuk qe bërë mesnata. As ajo vet nuk e dinte se përse Tomas Wilson kishte lënë një takim kaq të çuditshëm. Ishte mesnatë, nuk qe ndonjë kohë adekuate për takim të parë, por ai qe arsyetuar me pretekstin se ishte shumë i turpshëm, dhe se nuk donte që dikush t’i shihte së bashku në park, duke penguar, sipas tij, përhapjen e fjalëve dhe dënglave nga më të ndryshmet që do mund të sajoheshin.

Ajo vendosi të ulej në një ulëse aty diku, në park. Një fletushkë nga këto të reklamave kishte qenë aty afër. Mori fletushkën dhe pastroi stolin me të. Ajo priti. Priti për një kohë të gjatë. Murrani kish zënë të frynte së tepërmi këtë periudhë të vitit, bënte ftohtë i madh, por Olivia Harris priti. Vendosi që t’i bënte ballë tërë asaj furtune, vetëm e vetëm që të takonte Tomas Wilsonin. Kishte kaluar thuajse gjysmë ore dhe askush nuk qe paraqitur në park. As edhe një njeri i gjallë. Disa të lehura qensh u dëgjuan matanë dhe dukeshin sikur ata po vinin në drejtim të saj, sakaq, Olivia Harris vendosi të ngrihej e të kthehej në shtëpi. Vendosi kufjet në vesh dhe u nis kokulur duke shpejtuar paksa hapat, nga frika se mos vallë qentë endacak do ta sulmonin.

Kaloi një copë here dhe tashmë të lehurat e qenve nuk dëgjoheshin më.

Kishte kaluar mesnata dhe nuk dukej asnjë shenjë nga Tomasi. Olivia nxori celularin dhe i nisi



një mesazh duke i treguar se ajo kish kohë që e priste, por ajo që mori ishte vetëm një *typing...* i cili më pas u zhduk, dhe asgjë më shumë.

Olivia u dëshpërua rëndë. Mendoi me vete se ai vetëm qe tallur me të dhe asgjë më shumë. Sa kish filluar të mendonte se dikush me të vërtetë e donte dhe nuk do e linte për dikë tjetër, pa se kjo i doli dardhë me bisht. Ajo vetëm uli kokën dhe u nisë drejtë shtëpisë, me lot në sy.

Në rrugë e sipër, asaj iu duk se dikush ishte prapa saj. Ishte thjeshtë një hije, ajo se çka Olivia vërente. Hoqi njëren kufje, ktheu kokën prapa, por nuk ishte askush. Ajo vështroi mirë e mirë në të gjitha anët, por askush nuk qe me të. Sakaq ajo vendosi kufjen në vesh dhe vazhdoi rrugën pa e lodhur fort mendjen.

Diku afro pesë minuta më vonë, hija të cilën Olivia Harris mendoi se e pa prapa saj, tashmë iu shfaq për kundruall. Olivia Harris u zverdh në fytyrë dhe filloi të dridhej. Kundruall saj gjendej një burrë i veshur me një fustan të gjerë e të zi, i cili ishte i zgjebosur dhe i vinte gjer të gjunjët e tij, të cilët ishin tejet të rrudhur dhe të nxirë nga plagët.

Olivia Harris u spraps dhe filloi të vrapoi në drejtimin e kundërt. Çdo gjë i dukej e njohur, çdo gjë i dukej e parë diku! Ajo vetëm vraponte. Dihaste fortë dhe vraponte, gjersa burri i panjohur me fustan të zi, e ndiqte nga pas. Vrapimi bëhej gjithmonë e më i vështirë kur para vetes kishte rrugët e akullta në të cilat rrëshqisje e nuk mund të ecje.

Pylli ishte fare afër parkut. Vetëm një barrierë e lehtë i ndante ata të dy. Olivia Harris mendoi se ndoshta do të ishte zgjidhja më e lehtë që t’i ikte burrit-grua nga duart, po qe se ajo do fshihej në pyll.

Ajo vetëm vraponte. Dihaste fortë dhe vraponte, gjersa burri i panjohur me fustan të zi, e ndiqte nga pas. Ndonëse ajo u fut thellë në pyll, burri me fustan të zi vazhdonte ta ndiqte nga pas.

Ajo vraponte dhe mezi merrte frymë.

Për një çast, asaj iu kujtua se të njëjtën skenë kishte parë tash e disa net në makthet e saja.

“Kjo nuk është e mundur!” – mendoi me vete Olivia Harris gjersa ajo vraponte drejt një peme të trashë, duke shpresuar se i panjohuri nuk do ta shihte, po qe se ajo do fshihej aty. Me drojë dhe dridhje trupi, vendosi kokën jashtë trupit të pemës, për të parë se mos vallë i çmenduri burrë-grua tashmë ish larguar.

Asgjë nuk shihej. Gjithçka ishte e qetë. Madje as të lehurat e qenve nuk dëgjoheshin. Ajo mori frymë thellë dhe e nxori atë, duke u kthyer me shpinë nga pema, për të parë se burri me fustan të zi ishte prapa saj. Ai e kapi për fytyrë dhe e shtyu drejt trupit të pemës.

Ai qeshte. Ishte një buzëqeshje e uritur. Ishte djallëzore dhe e çuditshme. Ishte e frikshme!

Duke qeshur me të madhe ai filloi të grushtonte mbi fytyrën e Olivia Harris. Grushtonte me gjithë forcën e tij. Grushtonte dhe qeshte gjersa fytyra e Olivia Harris ishte përgjakur e tëra mbi dëborën e bardhë e të pastër.

Në pyll nuk dëgjohej asnjë zhurmë tjetër pos së qeshurës së burrit me fustan të zi dhe goditjeve që ai i jepte Olivia Harrisit.

*

Sakaq në park, shumë më larg pyllit të dendur, dëgjohej zëri i një gruaje plakë që thërriste qenushin e saj të humbur. Ajo bërtiste me sa fuqi që kishte. Endej nëpër park duke thirrur e kërkuar për të dashurin e saj, Coco. Në sy i ra një fletushkë e cila qe hedhur në rrugë. E mori dhe e lexoi. Frymëmarrja e saj ishte e thellë dhe e prerë. Ajo se çka shkruhej në letër e frikësoi tej mase.

Fletushka në fjalë ishte një afishe në të cilën shkruhej: KUJDES! Nëse shihni këtë person, lajmëroni policinë! Ai është i rrezikshëm për të gjithë. Kënaqësinë e tij, e gjen në vuajtjet dhe vdekjet e të tjerëve. Kini kujdes! Nëse shihni këtë person, lajmëroni policinë!

9. 2020 – Prishtinë

KOLEGËT PËR DAN MUSLIUN

PETRIT PALUSHI

Para pak ditësh u nda prej jete Dan Musliu (31 maj 1954 - 22 tetor 2020), poeti dhe kritiku elitar i letrave shqipe.

Te Dani merrte kuptimin e duhur fjala NJERI; ishte më tepër se i kulturuar, aristokrat në fjalën e vet. Mbas A. Pipës dhe I. Rugovës mbetet kritiku letrar më i dallueshëm në letrat shqipe.

Ndarja prej jete e Danit la pikëllim të madh të natyrshëm te kolegët.

Fjalët e tyre, jo vetëm nderim për kontributin e dallueshëm të tij në letrat shqipe, por njëkohësisht edhe një formë ngushëllimi, sepse tash e tutje edhe pa praninë e tij fizike do mbeten kujtimet për të dhe komunikimi me veprën e tij letrare.

Në këtë material përzgjedhëm vetëm disa prej shënimeve të kolegëve...



LAZËR STANI

Poet, mendimtar, kritik, publicist dhe mbi të gjitha njeri fisnik

Të gjithë ne, njerëzit e kësaj toke, e humbim betejën tonë të fundit.

Beteja jote e fundit paska qenë me Covid 19 miku im i paharruar, Ramadan Musliu. Fjalët janë të pafuqishme për ta përshkruar dhimbjen kohe të errët. Pushofsh në paqe!



BARDHYL LONDO

Kambana

(Kushtuar mikut tim, Dan Musliu)

Ky qytet maskë vazhdon jetën e tij, askush nuk qesh, askush nuk qan. Shpirti im kambanë tingëllon: Dan, Dan, Dan...



AGRON TUFA

Vjeshta e mbrame e poetit Ramadan Musliu

(31 maj 1954 - 22 tetor 2020)

Ikja e papritur e Ramadan Musliut, poetit dhe kritikut të shënuar të letrave tona më goditi dhe mua, si shumëkënd tjetër besoj, që e ka çmuar letërsinë e tij, kontributin krijues e intelektual të Danit. Ai ishte një natyrë e urtë, sqimatare, një burrë jashtëzakonisht i këndshëm e i çiltër kur gjente kuvendues. Kam mësuar shumë prej dijeve të tij në mes të viteve '90. Përtej fjalëve dhe mpirjes që më pushton, dua t'ju sjell një pjesë nga ajo pavdekësi e poetit Ramadan Musliu, i cili gjatë gjithë karantinës së këtij viti na solli zërat e pavdekësisë me poetë nga gjithë kulturat. E hidhur të mendosh se kjo paska qenë vjeshta e mbrame e poetit. Prandaj për vete dhe për miqtë e poezisë po sjellim një pjezës të tij, ku mendoj se

harrimi nuk është i pushtetshëm: Poezitë. Dhe mendoj se mbijetesa e poetit s'ka ku provohet më mirë, përveçse në silabet e vargjeve të tij.

Lamtumirë Dan, poet e njeri fisnik!



VIRION GRAÇI

Kritik elegant, krijues tepër i kultivuar

E kam njohur Danin kur u vendosën në Tirane me gazeten "Rilindja".

Kemi shkëmbyer libra dhe i kemi kujtuar shoku-shokut libra që mund të na interesonin; kemi shkëmbyer mendime, shaka, humor e komente të shpenguara miqesore aq sa na e lejonte sqima, etika, tavolina dhe diferenca në moshë.

E kam çmuar Danin sepse kishte lexuar e asimiluar sistematikisht çdo gjë me vlerë që ishte botuar në gjuhën tonë shqipe. Në këtë mënyrë ai nuk kishte dehjen e ngazëllimin mitizues që na perfshinte shpesh ne rishtarëve aso kohe që porsa zbulonim Prishtinën letrare apo dhe shkrimtarët e ndaluar të Shqipërisë. Dani njihte mirë letërsinë botërore në emrat dhe veprat e saj me fundamentale e kjo mbase e ndihmonte të mos ishte albanocentrist i acaruar e folklorik por lexues i mirë, kritik elegant, krijues tepër i kultivuar e me vetëdije të lartë qytetare, ndryshe nga shume shqiptarë fodullë e mistrecë qe ndihen në guasken e tyre mëhallore si të jenë krejt gjithësia, olimpi i vlerave. Danin po ashtu e kam çmuar për tonin përherë të qetë, gati pëshpëritës në kuvendim, por vetvetiu arrinte te gdhendte edhe në gur fjalët e tij të matura, sintetizuese.

Poezia e tij do t'i mjaftojë të ketë një vend nderi në radhen e parë të poezisë shqipe; librat studimore do t'i mjaftojnë të ketë po ashtu të njëjtin vend në trashëgiminë tonë kritike. Cilësitë e tij njerëzore i mjaftojnë të jetë i paharrueshëm dhe i pazëvendësueshëm mes njerëzve të tij të afërm, kolegëve, shokëve e miqve.



ERMIR NIKA

Poezia e tij tejkalon disa rrafshe leximi

Ramadan Musliu përfaqëson jo vetëm një personalitet të shquar në poezinë shqipe, por në të njëjtën kohë edhe një lëvizje intelektuale, ku në epiqendër të saj ishte dhe deri në fund, mbeti fjala. Veprimtaria e tij ishte e gjerë dhe e shumëanshme, por diapazoni i tij letrar ishte i pafund. Poezia e tij tejkalon disa rrafshe leximi dhe mendimi lartohet deri në konceptin e mbujtur me kthejlltësinë e vizionit që parakalon epokat dhe hapësirat e ndërmjetme mes tyre. Mos kërkonit të gjeni thjesht një realitet shqiptar në veprën e Ramadan Musliut,

pasi përmasat e perceptimit dhe ligjërimit të tij artistik i përkasin gjithësisë. Kjo masë e ngurtë dhe e etertë njëherazi, ribëhet në vargun e Musliut nëpërmjet kujtesës dhe formave të panjohura të ekzistencës, të cilat transformojnë kohë pas kohe mbijetesën në botën e egër apo edhe atë virtuale, e cila hera herës duket si e kapur nga dukuri jashtëtokësore e më pas, papritur sundoresh nga përshtypja sikur papandehur jetojmë në një planet të shkëputur nga sistemi diellor. Zhvendosjet nga njëri skaj në tjetrin, jo gjithmonë përmbushin fillimin dhe vijimësinë e pelegrinazhit të asketëve të fjalës dhe mendimit të shkëputur nga përkohësia. Rrjedhimisht, kjo jetë sipas shkrimeve, mbetet vetëm një fragment i përlidhur në gjithëkohësinë e misionarit të veçuar që bart frymën e përcjellë nga apostujt dhe dishepujt e kahershëm dhe të sotëm, gjurmët e të cilëve gjenden ende përqark globit.



RUDOLF MARKU

Një gazetar i shquar në kohërat më të vështira

Nje poet i talentuar, aq dhe modest; një vlerë e vërtetë e mendimit kritik të letërsisë shqipe; një njeri i ditur, i përlurur dhe jashtëzakonisht i mirë; një gazetar i shquar në kohërat më të vështira; RIP, mik!



PREND BUZHALA

Lajm pafundësisht i trishtë

Shkoi në amshim njëra ndër figurat elitare të letrave shqipe, poeti e kritiku i spikatur letrar, Ramadan Musliu (1954-2020).

Lajmi është pafundësisht i trishtë!

Ngushëllime familjes, miqve dhe komunitetit krijues!

Lamtumirë, mik i letrave!

I përjetshëm qoftë kujtimi për të!

HALIL MATOSHI

Pusho i qetë më paqen e pasosun, koleg e mik!

Iku kritiku dhe esteti fenomenologjik heideggerian, Ramadan Musliu.

Covid19,

Monstrumi i dalun nga honet e terratisuna, shkaktue na kâ sot edhe ni zi, tue marrë simas rregullit të fundbotshëm poetin e kritikun e letrave, gazetarin e mikun Ramadan Musliu.

Ndër lavruesit ma t'spikatun të gazetarisë kritike kulturore, në gazetën ikonike "Rilindja", Dan Musliu nuk ja duel në përballje me Covid19, tue marrë frymë për t'mramën herë në Spitalin skej qytetit të Prishtinës, pa ague dita e ëjte, e 22 tetorit.

Parandjenja.-

Në fund të vuajtjes sime

ishte dera.

Më dëgjo: Më kujtohet

ajo që ti e quan vdekje.

Mbi kokë zhurma. Dega e bredhit tundej

Pastaj asgjë.

(...)

Pikërisht me 8 të tetor, Dan Musliu e ka publiku në faqen e tina të Facebok-ut ni tubë me vjersha t'përkthyme të autores amerikane Louise GLÜCK, (1943), nga ShBA – fituese e Çmimit Nobel për letërsi, 2020 dhe në poezinë "Trishtimi i Kirkës", shoh një parandjenjë, një farë kodi të ni dere!?

Që paralajmëron mundësinë e daljës matanë gërditjes, në estetikën e dritës që përbirohet në plasat e derës!?

Chronoss-i.-

* I lemë n'Beguncë të Vitisë më 1954.

Gazetar dhe poet. Kritik mendjehollë, të cilin kur e kish pas lexu Ismail Kadare, tek shkruente për një nga veprat e tij, autori i shquem kish pas thënë "n'Shqipëri nuk shkruhet kështu!?".

(Simas rrimeve të kolegut e vendasit të Danit, Sami Piraj.)

Ishte një aluzion për interpretimin



ideologjik të artit në Shqipni, ku ka sunue gjatë doktrina socrealiste.

* Më 1988 e ka shkru për “Rilindja” e të shtunës, esenë (kritike) për librin tém t’parë poetik “Frymë varresh në dallgore”, me titull “Përafrimi i mitin me aktualitetin”, që ishte shkrimi i parë serioz për poezinë time.

Në ni farë mënyre, inkurajim e referencë, spari derë e hapun për me hy në botën e letrave shqipe.

* Me 2016 me propozim të atëherë Ministër Kulture Dr. Kujtim Shala dhe këshilltarit të tij Dr. Vehbi Miftari, ishim dytë anëtar të bordit të Teatrit Kombëtar të Kosovës. I ditun, konciz, i urtë që fjalët i kishte më kët’, Dani ishte një kundërshtar i thekun dogmës komuniste. Rugën nga Theatri Kombëtar deri tek sheshi i Zahirit zakonisht e banim bashk, flisnim edhe për letërsinë po edhe politikën. Anonte nga fenomenologjia Heideggeriane në diskursin kritik dhe estetik.

* Po në këtë tetor, rishtas u caktu nga Ministresha e Kulturës Vlora Dumoshi për me qenë pjesë e Këshillit Drejtues të Teatrit Kombëtar të Kosovës.

* Tue e kujtue Ragip Sylajn në Therandë, më 19 të Teorit, poetesha Naime Beqiraj më foli për lëngatën që ia kish zapue frymën Danit, por e menova t’fortë, që ka me e kapërcye këtë vrasës t’pa dokshëm e misterioz...

Coda.-

Ai hyni qetë e pa bujë në letrat shqipe ashtu, në vitet ‘80 të shekullit të kaluem, siç doli nga skena jetësore pa rrapullimë, beftë...

Në ditën e sotshme, 22 tetor, 2020.

Lamtumirë Dan.

Pusho i qetë më paqen e pasosun, koleg e mik!

Chronos-i t’vetmin lajm të vërtetë e sjell Thanatos-in.

Të tjerat janë veç se lojë, këndeje.

T’fala andej, Isufit, Isuf Gërvallës, Antonit, Gani Bobit, Brahimit, Beqës e Musës...

U thuej që rrallë e për mallë na bien në menje, vetëm kur shohim përreth shkreti dhe injorancë!?




ILIR SECI

Dani

Sot mora lajmin e hidhun të ikjes së beftë nga kjo jetë të mikut tem të mirë, poetit Ramadan Musliu. Danin siç e kena thirrë tanë, e kam njoftë në vjetën 1994 kur erdhi në Tiranë me redaksinë e gazetës “Rilindja”, gazeta “Rilindja” e Kosovës që hapi redaksinë në Tiranë mbasi shovinistët serbë e patën mbyllë redaksinë në Prishtinë. Për vite me rradhë e njoha kur bashkëpunoja me gazetën “Rilindja” botimi i Tiranës. Me Danin u bamë miq të mirë, u njoftëm familjarisht, ishte familjar i devotshëm, poet i shkëlqyer, studiues dhe kritik që ka me i mungue fort kulturës shqiptare, ishte njeri erudit, i perulun, modest te Zoti, që kurrë se ndigjoje duke folë në vetën e parë.

Dani ishte njeri joformal, jam i sigurtë se prej atje nalt ku ka shkue shpirti i tij kishte me thanë - “Leni bre këto eulogji” - ata që e kanë njoftë si une i dine mirë këto virtyte të tij. Qofsh i parajsës mik i mirë e uroj të kesh shkue në një botë ma të mire se kjo që le, një bote ku vlerësohen talenti, kultura, erudicioni, përkushtimi



dhe dashamirësia, virtyte me të cilat ishe i bekuem bujarisht...Zoti e forcoftë familjen e Danit në këtë humbje, gjindemi pranë familjes së tij, bashkëshortes Misretes, fëmijeve Sihanës, Mendimit, Ardianës, Lirës dhe tanë të afermëve të tij.



NAIME BEQIRAJ

Harresa nuk takohet kurrë me veprën tënde

Dan bre, pse bre Dan shkove?

Bisedën e fundit e bëmë të takoheshim pas dy ditësh në Prishtinë

“Redaktimin e librit ta besoj veç ty xha Dane”, unë me humor.

“Si gjithnjë. Edhe dy ditë besoj me kalon Covid e kolli, e lë fshatin e rikthehna në Prishtinë, qoftë edhe për ta pirë nga një kafe”, ai me humor.

Miku im, i mirë, më i miri. Poeti fin, kritiku më i mirë letrar që ka pas ky vend, i mbylli sytë përgjithmonë.

Njeriu që kurrë sëmundje në trup nuk pat, nuk piu duhan, nuk vuajti. Njeriu që bëri më shumë për të tjerët se sa për vete. Autori i disa librave me poezi, kritikë, studime, publicistikë. Më i dituri ndër ne. Zemra më dhemb për ty, Dan i dashur, për Misreten, për Syhanen, Mendimin, Ardianën e Lirën, për mbesat që ta ringjallën shpirtin - familje e rrallë ku flitej për artin e dashamirësinë, aty ku me dekada hëngra bukë e mora aq shumë dashuri.

Prisnim e luteshim që ditët e fundit me Covid të tejkaloheshin e ti përsëri të më qerasje me kafe në Elida.

Tash ke shkuar të prindët, të Ibrahim Rugova që e pate mik dhe e deshte shumë Kemi me të kujtu gjatë, Dan!

Harresa nuk takohet kurrë me veprën tënde.




SHAIPI BEQIRI

Zgavrat e çerekshekullit

Homazh mikut tim, Ramadan Musliut (31.V.1954 - 22.X.2020)

Nga ditët e para të mërgimit tim, para plot njëzet e pesë vjetësh, kur pati dhënë grahamën Anton Pashku, matanë kësaj bote kanë kaluar dhjetëra miq të mi, ndër më të dashurit e të shtrenjtët, kurse



sot asaj Çete të Ndritur iu bashkua edhe Ramadan Musliu.

Nuk e kisha menduar që premtimin në fund të një teksti për librin e tij të fundit të poezisë, shkruar para gati një vjeti, do të më duhej ta bëja duke e vazhduar me përkujtimin në ditën e grahamës së tij.

Më takoi fati të qëndroja e krijoja midis miqsh e shkrimtarësh të jashtëzakonshëm të dy brezave krijues të Kosovës; tek i pari qenë: T. Dervishi, B. Musliu e Y. Shkreli, kurse tek i dyti: A. Mala, R. Musliu e A. Konushevci. Deri tash mallin e pjesëtarëve të afërt të këtyre dy brezave krijues, tok me shumë të tjerë, sa herë vija këtu, e hijja deri në fund vetëm me R. Musliun; atje vazhdoj ta bëj ende me Y. Shkrelin e papërsëritshëm.

Ikja e poetit të jashtëzakonshëm dhe kritikut e studiuesit ndër më seriozët e të thellët që kishin letrat shqipe, më ngriu fjalën në grykë!



FARUK TASHOLLI

Dani ishte i parakohshëm

O miku im, Petrit! Dani ishte i parakohshëm. Ligjërimi i tij ishte ndesh me shablonet stereotipe të kohës. Ai do të shkonte një ditë si shkoi tash, por kam dhembje pa fund çfare truri ka hy në dhe!

JUSUF BUXHOVI

Kultura jonë mbeti pa krijuesin dhe intelektualin e madh.

Lamtumirë miku im, Ramadan Musliu!

Kultura jonë mbeti pa krijuesin dhe intelektualin e madh. Ndërsa vepra ime mbeti pa redaktorin dhe mentorin e fjalës së fundit...



ADEM GASHI

Gjettë prehjen e amshimit shpirti i tij!

Vajti matanë edhe Dani (Ramadan Musliu), miku im i gjeneratës së studimeve, miku im i letrave. Gjettë prehjen e amshimit shpirti i tij! Ngushëllime familjes e miqve!

SHQIPONJA AXHAMI TROTA

Sot në vendin tim vdiq një njeri

Zonja Kler, sot në vendin tim vdiq një njeri,

i fortë dhe hijerëndë. Një pemë e madhe...

Zonja Kler, sot dua të vish me mua tu hedhim gurabie mjelmave, duke u përsëritur vargjet e tij...

Zonja Kler, më mëso të lutem sharjen më të shpifur

dua t’ia këlthas në vesh vdekjes,

...

dhe zonja Kler më buzëqesh duke hedhur në koshin e riciklimit një deng gazetash...

p.s.

Ramadan Musliu, dhimbje dhe humbje për të gjithë



OLIMBI VELAJ

Qofsh i parajsës, njeri i bardhë!

Oh, lajm i hidhur! Si paska ikur Dani? Ai njeri dhe poet i mrekullueshëm, ai mik i patëdytë! Çfarë humbje! Unë nuk di si të ngushëlloj të afërmit dhe miqtë. Guxim për këte dhimbje! Qofsh i parajsës, njeri i bardhë! Kurrë nuk do të të harrojme ne të kësaj bote!



KALTRINË LOHAJ

U prehsh në paqe!

Nuk i ka nje muaj qe jemi takuar per here te fundit, e sa herë që mua më kanë ftuar ta moderoj një takim, arsyeja pse nuk kam mundur me refuzu një gjë të tillë je ti, e sa here që është dashtë me e prezantu emrin tend une jam ndjere e vogel sepse prezantimi për ty ka qenë i mangët.

Si mundesh me prezantu nje kritik letrar kaq te pa zevendesueshem te letrave tona.

Une e kam dite qe ke qene njeri i mirë, por sot edhe me shume, kur kam pare persona qe kane qajtë në zë kur më kanë treguar që ke ndërruar jetë. Është kaq e ftohte vdekja, por sot e kam ndjere edhe me te ftohte mengjesin, sepse asesi s’po mundem me e pranue qe me nuk do te jesh mes grupit tonë të vogel shoqeror, i cili jam e bindur nuk do ta ketë më atë ngrohtesinë e njejtë si më parë... Gjithmonë do të jesh ne mendjet tona... U prehsh në paqe!



NDUE UKAJ

Ti jetove në zemrën e gjërave

ÿLamtumirë Dan Musliu!

Kjo vjeshtë e hershme të këputi nga fjalët, ku jetove me dinjitet.

Ti jetove në zemrën e gjërave, prej ku, me fisnikëri krijove botë të bukura letrare.

Do të kujtojmë të qeshur e plot energji, me sibilat e tua melodike.

Do të kujtojmë si njërin nga mendjet më fisnike të Prishtinës. Si intelektual të vërtetë dhe të rrallë ndër ne. Pushofsh në paqe!



ALEXANDER LARMAN

A është nepotizmi artistik një e keqe apo nevojë?

Para ca ditësh, zbulova se një shkrimtare e re, e talentuar, po botonte romanin e saj të parë. Dukej se kishte një histori të mirë, madje edhe të pazakontë, kishte punuar si shitëse librash në librarinë e vlerësuar Mr.B Emporium dhe kishte botuar si debutuese një përmbledhje me tregime. Pastaj më kapi syrin emrin, Naomi Ishiguro. Reagimi i parë ishte të pyesja nëse ishte thjesht rastësi që ajo kishte të njëjtin mbiemër me autorin anglo-japonez, fitues të çmimit Nobel, Kazuo Ishiguro, por doli që s'ishte rastësi. Ajo u intervistua nga The Guardian për shkrimet e saj dhe dukej gjakftohtë për të atin e famshëm, duke thënë për Çmimin e tij Nobel se “mezi arrija të flisja me të në telefon sepse ishin gjithë këta gazetarë jashtë shtëpisë”. Ajo vuri në dukje po ashtu se me të atin shkrimtar kishte ndjesinë se karriera e shkrimtares “ngjan e mundur, s'është diçka krejt mistike” dhe se “ti mendon: mund të më ndodhë nëse dua, vetëm se duhet të punoj shumë”.

Ideja e nepotizmit është çështje që të ngjall kaq shumë ndjenjën e zemërimit dhe mllëfit, veçanërisht në kontekstin artistik ose letrar. Për shumë shkrimtarë ose aktorë rishtarë, sidomos, dyshimi më i madh është se të dyja industritë në thelb funksionojnë si një dyqan i mbyllur dhe leja e hyrjes në këto profesione magjepsëse dhe të paguara mirë mund të merret vetëm duke pasur lidhje me një emër të famshëm ose lidhje të ngjashme me njerëz që kanë status të lartë shoqëror.

E mbaj mend ende sagën fatkeqe të gazetarit të ri Max Gogarty, të cilit iu kërkua nga The Guardian të shkruante një seri blogësh për udhëtimet e tij gjatë lejes njëvjetore të dhënë nga gazeta. Gogarty i atëhershëm 19-vjeçar,

fillimisht u rraskapit për shkak të mënyrës pakëz të sinqertë dhe këndvështrimit parodik për veten si pjesëtar i klasës së mesme i cili - “punonte në një restorant me shumë njerëz të bukur, argëtues; po shkruante një dramë; i dërgonte shkrime revistës Skins; të gjitha paratë që fitonte i shpenzonte për ushqim dhe blerje xhinsesh të ngushta, jepej pas pijes gjatë një udhëtimi dymujor goxha të shtrenjtë nëpër Indi dhe Tajlandë”, por më pas doli se nuk ishte ai por i ati gazetari i pavarur që i bënte këto udhëtime dhe ia shkruante artikujt që ai herë pas herë ia dërgonte gazetës, dhe kjo shkaktoi një skandal të paparë. Po të kishte Twitter asokohe, do të flisnin për të me ditë të tëra.

Blogë të Gogarty-t në të vërtetë s'pati, por që prej atëherë ai ka pasur një karrierë të suksesshme në media, duke punuar si menaxher botimesh në BBC. Mund të ketë ende disa luftëtarë të pakënaqur të tastierës që mermërisin se suksesin e ka për shkak të të atit, por shumë të tjerë kanë pasur arritje gjatë këtyre 12 vjetëve qëkur Gogarty u përpoq dhe s'arriti të bëhej një gazetar i pavarur. Përveç kësaj, ka patur shumë objektiva të tjerë që nga ajo kohë. Shfaqja e shkëlqyer e Netfliksit për edukimin seksual është një nga programet më të reja dhe më të mprehta që ka dalë prej platformës që nga fillimi, por shumë ngritën dyshime për faktin se nga doli aty krijuesja e saj Laurie Nunn, duke pasur parasysh që ajo s'kishte asnjë histori suksesi para se të drejtonte një program të tillë me shikueshmëri kaq të lartë. Pati disa shpjegime në një intervistë të pashmangshme me The Guardian - a shohim të jetë krijuar një model këtu? – ndërsa artikullshkruesi

komentonte, “E ëma është aktoria australiane Sharon Lee-Hill; i ati është regjisori britanik i teatrit Trevor Nunn”.

Laurie Nunn, megjithatë, ashtu si Naomi Ishiguro, nuk shfaqësohet që përdor statusin e saj të privilegjuar dhe emrin e njohur të familjes për të vazhduar karrierën. Siç tha në intervistë, “Duke pasur një familje të dhënë pas artit më bëri të ndiej që në moshë shumë të re, se kjo ishte një mundësi edhe për mua. Kam miq në fushën e arteve, familja e të cilëve s'është e lidhur me këtë fushë, dhe u ngjan si një perspektivë e frikshme. Ata patjetër që më kanë nxitur ta ushqej pasionin tim”. Padyshim që ndihmon për t'u vënë re, nëse yt at është ish-kreu i Teatrit Kombëtar, por është po aq e vërtetë që programi i saj është një punë e vërtetë e jashtëzakonshme. Mbiemri i famshëm mund të ketë hapur dyer dhe të jenë bërë disa takime, por talenti i ka siguruar sukses në karrierë.

Çështja e nepotizmit kanë qenë thelbësore për letërsinë gjatë shumë e shumë brezave. Ndërsa shumica e shkrimtarëve legjendarë anglezë të shekullit të njëzetë, Dickens, Shakespeare, Austen dhe të tjerë - nuk vinin nga familje me traditë letrare, profesioni asokohe varej shumë nga individët e talentuar të cilëve u jepej mundësi për shkak të meritave, në vend se të mbështesnin shkrimtarë që rrekeshin të ecnin në gjurmët e prindërve të njohur. Ndoshta shembulli më i shquar i kundërt me këtë traditë gjendet në letërsinë e shekullit të njëzetë me Martin Amis-in, romani i parë i të cilit “Letrat për Rashelën” u botua më 1973, kur ishte 24 vjeç.

Ai ka bërë komente të ndryshme rreth asaj se si shkrimtaria për të s'ishte asgjë më shumë sesa "marrja me një punë të familjes", sikur letërsia të ishte një zanat si të jesh kasap ose drejtor funerali, dhe vërejti se ishte e pashmangshme që çdo botues donte të investonte në brezin e dytë të një dinastie shkrimtarësh. I ati, Kingsley ishte një nga më të njohurit e letrave në Britani në fillim të viteve shtatëdhjetë dhe vazhdoi të ishte një nga shkrimtarët kryesorë të vendit derisa ndërroi jetë më 1995, kështu u krijua përshtypja e fortë se ishte fama e tij që ia kishte shtruar rrugën të birit në krijimtari. Jo pa ironi ai u shpall nga Neë Statesman, për librin "Martin Amis: Lufta ime", fitues i konkursit për titullin e librit që s'ngjan fare si titull libri. Mbetet gjithsesi ndjesia se ata që kanë koniunktura të mira janë në gjendje të luajnë pa ndonjë vështirëse rolin e më të mirit.

Nëse nepotizmi është një faktor kryesor në letërsi, ai është edhe më i përhapur në profesionin e aktrimit. Gjithmonë ka pasur dinasti të mëdha pjesëtarët e të cilave zakonisht kanë patur pozita të larta profesionale që në hapat e pare, familjet e artistëve Fondas dhe Barrymores në Amerikë, Redgraves dhe Foxes në Britani - dhe, duke pasur parasysh sa mllengjall kjo tek shumë aktorë pa punë, mbetet ajo përshtypja se vetëm ata që kanë lidhje të forta dhe arsimohen privatisht dhe në Oxbridge janë në gjendje të zgjidhen për rolet më të mira pa ndonjë vështirësi. Për të përmendur vetëm disa prej aktorëve më të suksesshëm të Britanisë sot si Benedict Cumberbatch, Kate Beckinsale, Samuel Ēest, Daniel Radcliffe, Rory Kinnear, Harry Lloyd dhe Hattie Morahan, secili prej tyre ka prindër që janë ose aktorë të respektuar (si në rastin e Beckinsale, Ēest, Cumberbatch ose Kinnear), regjisorë (Morahan) ose të përfshirë në industrinë e argëtimit në nivele të larta; babai i Lloyd Jonathan-it është presidenti i agjencisë kryesore të talenteve. Në Amerikë, situata është pak më ndryshe, dhe pa dyshim edhe më e keqe. Shihet ngritja e Maya Haëke, Kate Hudson, Dakota Johnson, Jaden Smith, Lily-Rose Depp dhe shumë të tjerëve dhe thjesht tregon se në industrinë miliarda dollarëshe e filmit disa nga rolet më të mira janë për ata me prindër të famshëm të cilët kanë lidhje të ngushta me biznesin. Kështu ka qenë qëkur John dhe Lionel Barrymore filluan karrierën në ditët e hershme të kinemasë, duke u siguruar që emrat e tyre të njohur të vazhdonin të ishin brenda industrisë, veçanërisht në rastin e Dreë Barrymore-it. Pavarësisht nga diskutimet e hapura të industrisë për "barazi" dhe "drejtësi", të shprehura së fundmi me përqindje tek të gjithë filmat e nominuar për Çmim e Akademisë, askush s'ka provuar seriozisht të argumentojë se fëmijët e të famshmëve dhe aktorëve s'duhet të kenë trajtim të veçantë. Duket se nepotizmi është gjallë, mirë dhe midis nesh, për të qëndruar gjatë.

Ndoshta jeta ime do të ishte më e lehtë nëse do të kisha mbiemrin Stoppard ose Mantel. Pyetja është se sa duhet të shqetësohemi nga ekzistenca e tij dhe

çfarë mund të bëhet për këtë. Nga njëra anë, është pa dyshim krejt e padrejtë dhe zhgënjyese që industrinë letrare dhe të aktrimit, e kanë mbiemrin e famshëm dhe përkatësinë në një familje të njohur gjithnjë e më shumë një parakusht për të filluar një karrierë. Megjithatë, nga aktorët britanikë të përmendur më lart, të gjithë (me përjashtim të Radcliffe-it) shihen si ndër më të shquarit në fushën e tyre, të vlerësuar për punën e shkëlqyer në film, televizion dhe skenë. Është e mundur të argumentosh, siç bën Laurie Nunn, që duke u rritur në një mejdis me aktorë, shkrimtarë dhe regjisorë, ata kishin besim dhe përvojës për ta karrierën, e cila u mungonte bashkëmoshatarëve të tyre, gjë që shpjegon pse karriera e tyre ka lulëzuar ndërsa shumë të tjerët nuk e kanë patur një karrierë të tillë. Po ashtu, do të kishte qenë befasuese për vajzën e Kazuo Ishiguros që të mos ishte rritur në një atmosferë respekti dhe kureshtjeje për letërsinë, është edhe puna si librarshitëse dhe tani po hedh hapat e parë në karrierën e shkrimit.

Nepotizmi është fjalë e shëmtuar dhe shumë mendojnë se situata në të cilën ndodhemi është një situatë e shëmtuar dhe e padrejtë, e cila duhet të ndryshoj. Si dikush që e ka filluar karrierën gazetareske dhe të shkrimit pa një emër të famshëm apo mbështetje nga një i afërm i njohur, s'mund ta mohoj ndjesinë se pa dyshim në shumë raste jeta ime do të kishte qenë më e lehtë nëse mbiemrin do ta kisha, letë themi, Stoppard ose Mantel. Por shumica e shkrimtarëve, dhe shumë aktorë, e kanë bërë karrierën pa përfitime të tilla. Është e pamohueshme që ekziston një hamendësim se fëmijët e të mirënjohurve, të cilët shpesh lindin në pasuri të madhe dhe privilegje gjithsesi, thjesht mund të zënë vendin e tyre në tryezë pa pasur nevojë të luftojnë për të por ata s'do të jenë në gjendje të qëndrojnë nëse aty i ka çuar vetëm emri. Merrni, për shembull, Jason Connery ose Kimber Eastwood, asnjëri prej të cilëve nuk pati kurrë një karrierë që arrinte atë të baballarëve të tyre të famshëm.

Në fund të fundit, talenti do të ngadhënjejë. Nëse është i trashëgueshëm, aq më mirë, por frekuentuesi mesatar të kinemasë apo një blerësi të librit i bën përshtypje vetëm një emër i njohur. Në fund fare, do të indoheshim më mirë nëse merremi më pak me përparësitë (e padrejta ose jo) që duket se gëzojnë të mirënjohurit dhe në vend të kësaj të sigurohemi që këta që nuk kanë prindër të njohur të kenë gjithashtu mundësi qasjeje në këto industri ku është e vështirë të hysh. Përndryshe, rrezikojmë të kemi një mungesë kaq të madhe larmie, sa edhe The Guardian do të detyrohet të resht së botuari intervista dhe të botojë shkrime për fëmijët e të famshmëve (përfshirë shkrimtaren Bella Mackie, vajza e ish-kryeredaktores së kësaj gazete Alan Rusbridger) – se pastaj kush e di se sa pa përmbajtje do të jenë?

Përktheu: Granit Zela



OnufriMinis

Edgar Allan Poe

Pusi dhe lavjerrësi



Edgar Allan Poe

Shembja e shtëpisë Asher



Charlotte Perkins Gilman

Letra e verdhë e murit



H. G. Wells

Dyqani magjik





BASHKIA SHKODER
BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"



24, 25, 31 Tetor, 1 Nëntor 2020
Biblioteka "Marin Barleti", Shkodër

**FESTIVALI
LETRAR**

I SHKODRES